


# BARAZIA GJINORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË DHE AGJENDA PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM 2030

Analiza e lidhshmërisë së dokumenteve strategjike nacionale për barazi gjinore në realizimin e Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm



**Redaktore:** Kristina Pleçiq Beqarova

**Autorë:** Bojan Jovanovski, Damjan Zdravev, Sanella Shkrijel, Sneshka Iliq

**Radhitja grafike:** Grigor Unkovski

**Përkthimi në shqip:** Gramoz Shabani

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

502.131.1:305(497.7)(047.3)

BARAZIA gjinore në Republikën e Maqedonisë dhe agjenda për zhvillim të qëndrueshëm 2030 : analiza e lidhshmërisë së dokumenteve strategjike nacionale për barazi gjinore në realizimin e Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm. - Shkup : Asociacionit për edukim shëndetësor dhe hulumtim H.E.R.A., 2016. - 40 str. ; 20 cm

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4598-66-4

а) Одржлив развој - Родови аспекти - Македонија - Извештаи  
COBISS.MK-ID 102006026

# PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| Rezyme.....  | 4  |
| Hyrje.....   | 6  |
| 1. Shëndeti seksual riprodhues dhe Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm.....   | 8  |
| Shëndeti seksual dhe riprodhues në Strategjinë për barazi gjinore 2013 – 2020 dhe Plani aksionar nacional 2013 – 2016 dhe kontributi ndaj Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm..... | 10 |
| Në cilën masë informatat nacionale dhe statistika për SHSR janë të mjaftueshme për vëzhgimin dhe raportimin ndaj QZHQ.....   | 12 |
| Rekomandime.....   | 13 |
| 2. Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave dhe Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm.....   | 15 |
| Fuqizimi ekonomik i femrës në Strategjinë për barazi gjinore 2013 – 2020 dhe Plani aksionar 2013 – 2016 dhe kontributi ndaj Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm.....               | 17 |
| Në cilën masë të dhënat nacionale dhe statistikat për SHSR janë të mjaftueshme për vëzhgimin dhe raportimin drejt QZHQ.....  | 19 |
| Rekomandime.....   | 21 |
| 3. Pjesëmarrja politike e femrave/inkuadrimi i femrës në vendimmarrje dhe Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm.....  | 22 |
| Pjesëmarrja politike e femrës në Strategjinë për barazi gjinore 2013 – 2020 dhe Plani aksionar 2013 – 2016 dhe kontributi drejt Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm.....           | 24 |
| Në cilën masë të dhënat nacionale dhe statistika për pjesëmarrjen politike të femrës janë të mjaftueshme për vëzhgim dhe raportin ndaj QZHQ.....                                     | 26 |
| Rekomandime.....   | 29 |
| 4. Dhuna e bazuar në gjini dhe Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm.....   | 30 |
| Dhuna e bazuar në gjini në Strategjinë për barazi gjinore 2013 – 2020 dhe Plani aksionar 2013 – 2016 dhe kontributi ndaj Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm.....                  | 33 |
| Në cilën masë informatat nacionale dhe statistika për pjesëmarrjen politike të femrës janë të mjaftueshme për vëzhgimin dhe raportimin ndaj QZHQ.....                                | 35 |
| Rekomandime.....   | 37 |

## Lista e shkurtesave

AZHQ – Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm 2030  
PAN- Plani aksionar nacional për barazi gjinore 2013 – 2016  
DHBGJ – Dhuna e bazuar në gjini  
SBGJ – Strategjia për barazi gjinore 2013 – 2020  
SHSR – Shëndeti seksual dhe riprodhues  
QZHQ – Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara  
ISHP – Instituti për shëndet publik  
EMSHNF – Enti për mbrojtje shëndetësore të nënave dhe fëmijëve  
MPPS – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale  
MPB – Ministria e Punëve të Brendshme  
ESHS – Enti Shtetëror për Statistikë  
NJVL – Njësitë e vetëqeverisjes lokale

# Rezyme

Barazia gjinore në Agjendën për zhvillim të qëndrueshëm 2030 (AZHQ) është çështje së cilës i jepet rëndësi e madhe. Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm (QZHQ), i trajtojnë çështjet gjinore në mënyrë të ndjeshme dhe ndërton pritje se barazia gjinore do të merret për prioritet në politikën e re globale për zhvillim të qëndrueshëm të shteteve. Në nivel nacional, Republika e Maqedonisë në mënyrë strategjike i qaset mundësimin të barazisë gjinore përmes një sërë masash të rëndësishme për zhvillim të politikave, më së shumti të reflektuara në Strategjinë për barazi gjinore 2013 – 2020 (SBGJ) dhe Planit aksionar nacional 2013 – 2016 (PAN). Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me vlerësimin e lidhshmërisë së QZHGJ me barazinë gjinore në Republikën e Maqedonisë përmes rishqyrtimit të qasjes dhe analizës së dokumenteve strategjike nacionale, gjegjësisht SBGJ dhe PAN.

Analizoi tregoi se dokumentet strategjike nacionale kanë lidhshmëri solide me qëllimet e orientuara drejt barazisë gjinore, por megjithatë shkallë të kufizuar të harmonizimit me detyrat dhe indikatorët nga agjenda. Për shkak të avancimit të politikave dhe proceseve lidhur me AZHQ në pjesën e barazisë gjinore, Republika e Maqedonisë në përgjithësi do të duhej të qaset drejt rishqyrtimit të dokumenteve strategjike nacionale në këtë fushë, dhe t'i përmirësojë sistemet për grumbullimin e të dhënave që janë të domosdoshme për vëzhgimin dhe matjen e avancimit të shtetit.

Për realizimin e AZHQ në Republikën e Maqedonisë në kontekst të barazisë gjinore, ndërsa me qëllim të avancimit të pozitës së grave dhe vajzave dhe mbyllja e hendekut gjinor, katër fushat tjera janë veçuar si të rëndësishme në këtë analizë: shëndeti seksual dhe riprodhues, forcimi ekonomik dhe politik i grave dhe vajzave dhe dhuna e bazuar në gjini.

Shëndeti seksual dhe riprodhues (SHSR) zë vend të rëndësishëm në AZHQ dhe rëndësia e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë njihet si faktor në avancimin e barazisë gjinore. Nga ana tjetër, në SHSR dhe PAN, shëndeti seksual dhe riprodhues nuk është inkuadruar në mënyrë adekuate. Mungesa e SHSR si qëllim specifik në këto dokumente krijon vështirësi për vëzhgimin dhe plotësimin e detyrave nga AZHQ. Në të njëjtën kohë, mungesa e masave konkrete dhe gjithëpërfshirëse e zvogëlon rëndësinë e SHSR në planifikimin nacional për arritjet e barazisë gjinore. Mungojnë masa dhe të dhëna të ndara në formularët për grumbullimin e informatave te institucionet shëndetësore, që nuk e mundëson vëzhgimin më të mirë të avancimit të shtetit në pikëpamje të SHSR dhe QZHQ.

Forcimi ekonomik i grave është një nga prioritetet e përfshira në AZHQ, gjatë së cilës dokumentet strategjike nacionale për barazi gjinore në Republikën e Maqedonisë në mënyrë adekuate e adresojnë këtë çështje. Megjithatë, analiza tregon harmonizim të pjesshëm në qasjen dhe kontributin e kufizuar të SBGJ dhe PAN në pikëpamje të QZHQ për forcimin ekonomik të grave dhe vajzave.

Analiza e pjesëmarrjes politike të grave dhe inkuadrimi i grave në vendimmarrje tregon se qëllimet në Strategjinë për barazi gjinore dhe PAN, në masë të madhe janë në korrelacion me qëllimet në QZHQ, veçanërisht kur fjala është për sigurimin e pjesëmarrjes të plotë dhe efektive të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Aktivitetet e ndërmarra në SBGJ dhe PAN për plotësimin e QZHQ janë relevante, dhe të matshme përmes indikatorëve të cilat do të tregojnë nëse dhe sa është rritur pjesëmarrja e grave në politikat në nivel lokal dhe nacional. Megjithatë, strategjia nuk parasheh hulumtime dhe analiza të cilat tregojnë për shkallën e pjesëmarrjes qytetare të grave dhe meshkujve dhe mënyrën në të cilën qytetarët mund të inkuadrohen në vendimmarrje jashtë proceseve politike. Po ashtu, mungesa e informatave të ndara gjinore edhe më tej paraqet sfida për vëzhgimin e avancimit të shtetit lidhur me QZHQ, sfida e cila në mënyrë gjithëpërfshirëse duhet të adresohet gjatë përpilimit të PAN të ri.

Qëllimet në SBGJ dhe PAN lidhur me dhunën e bazuar në gjini, pjesërisht janë të lidhura me qëllimet në AZHQ. Strategjia e definon dhunën e bazuar në gjini dhe parasheh nëse kjo bazohet në pabarazinë mes meshkujve dhe femrave në shoqëri, gjatë së cilës i njëj format e ndryshme të dhunës së bazuar në gjini. Analiza ka identifikuar se sfida kryesore gjatë zbatimit të detyrave dhe vëzhgimin e indikatorëve lidhur me QZHQ, ndërsa moszbatimi i masave dhe aktiviteteve kundër të gjitha formave të dhunës së bazuar në gjini, për shkak të definimit jo të saktë, mosnjohjes dhe inkriminimit të gjitha formave të dhunës së bazuar në gjini në të gjitha dokumentet dhe ligjet strategjike.

# Hyrje

Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm 2030 e OKB-ve paraqet plan global për zhvillim të qëndrueshëm dhe aksion i cili ndërlidhet me Qëllimet zhvillimore mijëvjeçare dhe përfiqet “t’i çrrënjosë varfërinë dhe urinë; t’i kundërvihet pabarazisë në dhe mes vendeve; të ndërtojë shoqëri të drejta dhe inkluzive; t’i mbroje të drejtat e njeriut dhe ta promovojë barazinë gjinore dhe forcimin e grave dhe vajzave; dhe të sigurojë mbrojtje afatgjate të planetit dhe resurseve të saja natyrore”.<sup>1</sup> Kjo agjendë është e bazuar në tre shtylla për zhvillim të qëndrueshëm: zhvillimi ekonomik, zhvillimi social dhe zhvillimi i mjedisit jetësor dhe përfshinë 16 qëllime, 169 detyra dhe 231 indikatorë. Për vëzhgimin e implementimit të AZHQ, Komisioni për statistikë të OKB-ve, në procesin e gjerë participativ, zhvilloi komplet gjithëpërfshirës të indikatorëve, përmes të cilave do të vëzhgohet progresi i shteteve lidhur me qëllimet dhe detyrat e vendosura të QZHQ. Në AZHQ është parimi inkorporues “askush mos anashkalohe” që në të vërtetë nënkupton informata të nevojshme për vëzhgimin e progresit dhe sukseset e shteteve të ndahen në më shumë baza, duke përfshirë gjininë, moshën, racën, invaliditetin, të ardhurat, përkatësinë etnike, statusin e emigrantëve, por edhe karakteristika tjera relevante për çdo shtetas individualisht.

Barazia gjinore është një nga temat qendrore në Agjendën për zhvillim të qëndrueshëm 2030. Në AZHQ potencohet se “realizimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave do të japë kontribut të rëndësishëm në të gjitha qëllimet dhe detyrat”<sup>2</sup> dhe insistohet për inkuadrim sistematik të perspektivës gjinore në implementimin e përgjithshëm. Edhe krahas asaj që barazia gjinore trajtohet si çështje horizontale që duhet të adresohet gjatë realizimit të qëllimeve, në QZHQ është paraparë edhe qëllim i veçantë – Qëllimi 5 që është orientuar në mënyrë specifike drejt barazisë gjinore. Ky qëllim synon drejt forcimit të grave dhe vajzave dhe realizimit të potencialit të tyre të përgjithshëm që në mënyrë të domosdoshme nënkupton eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit në bazë të gjinisë dhe dhunës së bazuar në gjini. Po ashtu, Qëllimi 5 përfiqet të mundësojë avancimin e shëndetit seksual dhe riprodhues të grave dhe vajzave, njohja e punës shtëpiake të papaguar dhe qasjen e barabartë deri te resurset, si deh pjesëmarrja e barabartë me meshkujt në jetën politike, ekonomike dhe publike.

1 United Nations (2015) Resolution adopted by the General Assembly, Transforming our World: the 2030 Agenda for Sustainable Development, [http://www.un.org/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E](http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E)

2 United Nations (2015) Resolution adopted by the General Assembly, Transforming our World: the 2030 Agenda for Sustainable Development, [http://www.un.org/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E](http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E)

Duke pasur parasysh se Republika e Maqedonisë si anëtare e OKB-ve bazohet mbi implementimin e AZHQ, lënda e kësaj analize është të shqyrtohet se çfarë lidhshmërie të dokumenteve strategjike nacionale për barazi gjinore me QZHQ, por edhe kontributi i shtetit në realizimin e AZHQ. Gjatë kësaj, janë marrë parasysh Strategjia për barazi gjinore 2013 – 2020 dhe Plani aksionar nacional 2013 – 2016, si dokumente primare strategjike nacionale nga fusha e barazisë gjinore. Është e rëndësishme të theksohet se në Strategjinë për barazi gjinore është vërejtur se “Republika e Maqedonisë si vend anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara – OKB ka obligim gjatë planifikimit të politikave të udhëhiqet nga konventat themelore për të drejtat e njeriut, që i ka ratifikuar edhe qëllimet zhvillimore mijëvjeçare dhe t’i marre parasysh dokumentet e miratuara në konferencat e OKB-ve në drejtim të arritjes së qëllimeve sociale të miratuar në nivel global.”<sup>3</sup>

Ky dokument, përmes pasqyrës dhe krahasimit të dokumenteve strategjike nacionale për barazi gjinore me qëllimet dhe detyrat nga AZHQ, mundëson vlerësim të harmonizimit të tyre dhe korrelacionit. Në këtë mënyrë analizohet mundësia SBGJ dhe PAN të kontribuojnë në plotësimin e QZHQ, si dhe funksionimin e sistemeve ekzistuese për grumbullimin e informatave relevante për barazinë gjinore përmes të cilave do të matet shkalla e realizimit të QZHQ. Dhe më në fund, qëllimi i kësaj analize është të kontribuojë në identifikimin e sfidave dhe mundësive për implementimin e suksesshëm të AZHQ në Maqedoni dhe t’i propozojë drejtimet për avancimin e dokumenteve strategjike primare për barazi gjinore në drejtim të harmonizimit më të madh me prioritetet e OKB-ve.

Në këtë analizë fokusi është mbi katër fushat të cilat janë të përfaqësuara edhe në QZHQ dhe në SBGJ dhe të cilat mund të llogariten për prioritetet kur fjala është për avancimin e pozitës së grave dhe vajzave:

shëndetësia më saktë SHSR, forcimi ekonomik, përfshirja politike dhe dhuna e bazuar në gjini. Shkaqet për zgjedhjen e këtyre katër fushave janë mbështetur edhe me deklaratën e dhënë në Grupin ndër-resor dhe konsultativ për barazi të femrave dhe meshkujve (Shtator, 2015), me të cilën u mbështet propozimi i Kuvendit gjeneral të OKB-ve për vendosjen e qëllimit të veçantë për Gjininë, Qëllimi 5, por edhe angazhimet e dhëna nacionale për “eliminimin e të gjitha formave të dhunës mbi gratë dhe vajzat, avancimi i gjendjes ekonomike të femrës dhe përmirësimi i shëndetit seksual eh riprodhues përmes proceseve të krijimit të ligjeve, politikave, buxheteve dhe ndërmarrja e aksioneve dhe masave”<sup>4</sup>. Sipas kësaj, dokumenti është ndarë në katër tërësi të veçanta kushtuar fushave prioritare.

<sup>3</sup> Qeveria e Republikës së Maqedonisë (2013). Strategjia për barazi gjinore 2013 – 2020. Gjendet në: <http://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nsp>

<sup>4</sup> Grupi ndër-resor këshillëdhënës dhe konsultativ për barazi të femrës dhe mashkullit, Platforma për barazi gjinore, HERA (2015) Çështja gjinore, shëndeti seksual dhe riprodhues në kornizën zhvillimore për periudhën 2016 – 2030, [http://hera.org.mk/wp-content/uploads/2015/07/POST\\_2015\\_MK.pdf](http://hera.org.mk/wp-content/uploads/2015/07/POST_2015_MK.pdf)

Secila nga tërësitë përfshinë analiza të lidhshmërisë së SBGJ dhe PAN në zbatimin e QZHQ, pjesë e cila ka të bëjë me proceset për grumbullimin e informatave dhe qasjes deri te informatat relevante për vëzhgimin e shkallës së realizimit të QZHQ, si dhe një pjesë me rekomandime për avancimin e dokumenteve strategjike primare për barazi gjinore që të rritet kontributi drejt QZHQ.

## SHËNDETI SEKSUAL RIPRODHUES DHE QËLLIMET PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Barazia gjinore dhe pavarësia e grave dhe vajzave nuk mund të realizohen pa avancimin e SHSR dhe realizimin e të drejtave riprodhuese. Gratë dhe vajzat janë më shumë të ndjeshme për dallim nga meshkujt lidhur me shëndetin riprodhues dhe kjo mund të ndikojë negativisht mbi shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme të tyre. Mungesa e shërbimeve shëndetësore lidhur me SHSR mund ta rritë peshën e punës mbi gratë në sigurimin e kujdesit në familje me çka e pengon edhe vendimmarrjen për atë nëse, kur dhe sa fëmijë do të kenë. Prandaj, që gratë dhe vajzat të kenë jetë të shëndetshme dhe liri të plotë të pjesëmarrjes në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike, nevojitet të kenë qasje gjithëpërfshirëse deri te edukimi, shërbimet dhe prodhimet për SHSR, por edhe kornizë ligjore e cila do t'u mundësojë që t'i realizojnë të drejtat e tyre riprodhuese.

Qëllimi nr. 3 që ka të bëjë me shëndetin dhe Qëllimi nr. 55 i cili ka të bëjë me barazinë gjinore dhe forcimin e femrës nga QZHQ, drejtpërdrejt e njeh rëndësinë nga SHSR në avancimin e barazisë gjinore. Ato janë relevante edhe për kontekstin e barazisë gjinore në Maqedoni dhe janë lëndë e kësaj analize. Ekzistojnë edhe qëllime të cilat kanë elemente të SHSR (Qëllimi nr. 4, 6, 8, 10 dhe 16), port ato nuk do të analizohen në këtë dokument për shkak të kontributit të tyre indirekt ndaj barazisë gjinore ose irelvancës së një pjesë të këtyre qëllimeve në pajtim me nevojat për SHSR në vend. Në Qëllimin nr. 3 identifikojmë dy detyra për SHSR të cilat kontribuojnë drejt barazisë gjinore, gjegjësisht detyra 3.1. e cila ka të bëjë me uljen e shkallës së vdekshmërisë të nënat dhe detyra 3.7 e cila ka të bëjë me sigurimin e qasjes universale deri te shërbimet për SHSR, duke përfshirë edhe planifikimin e familjes. Po ashtu në Qëllimin nr. 5 ekziston lidhje e drejtpërdrejtë mes SHSR dhe barazisë gjinore, e dhënë përmes detyrës 5.6 sigurimin e qasjes gjithëpërfshirëse deri te SHSR dhe të drejtat riprodhuese në

5 United Nations (2015) Resolution adopted by the General Assembly, Transforming our World: the 2013 Agenda for Sustainable Development, [http://www.un.org/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E](http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E)



pajtim me Programin për Aksion të Konferencës ndërkombëtare për Popullatë dhe zhvillim<sup>6</sup> dhe Platforma e Pekinit për aksion.<sup>7</sup>

Për përcjelljen e detyrave për SHSR me rëndësi për avancimin e barazisë gjinore, Komisioni për Statistikë pranë Kombeve të Bashkuara<sup>8</sup> i rekomandon këto indikatorë (Tabela 1) me të cilët do të matet avancimi i vendeve, gjatë kësaj duke e ruajtur parimin “askush mos lihet anësh”.

**TABELA 1:** Shëndeti seksual dhe riprodhues në Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm

| <b>Detyrat</b>   | <b>Indikatorët</b>  |
|--|---|
| <p><b>3.1.</b> Deri në vitin 2030, të zvogëlohet shkalla globale e vdekshmërisë së nënave në më pak se 70 në 100.000 lindje.</p>   | <p><b>3.1.1.</b> Vdekshmëria e nënave në 100.000 lindje.<br/> <b>3.1.2.</b> Përqindja e lindjeve nga kuadri profesional-shëndetësor.</p>  |
| <p><b>3.7.</b> deri në vitin 2030, të sigurohet qasja universale deri te shërbimet për shëndet seksual dhe riprodhues, duke përfshirë planifikimin e familjes, informatë dhe edukim dhe integrim të shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet nacionale.</p> | <p><b>3.7.1.</b> % e femrave në periudhën riprodhuese (15-49) nevojat e të cilave për planifikim të familjes janë plotësuar me kontracëpsion modern.<br/> <b>3.7.2.</b> Shkalla e lindjes te adoleshentet (të moshës prej 10-14 dhe 15-19) në 1000 gra në grup moshë të njëjtë.</p>   |
| <p><b>5.6.</b> Të sigurohet qasje gjithëpërfshirëse dhe shëndet riprodhues dhe të drejta riprodhuese siç është martë vesh në pajtim me Programin për Aksion të Konferencës ndërkombëtare për popullatë dhe zhvillim dhe Platforma e Pekinit për aksion.</p>          | <p><b>5.6.1.</b> % e femrave të moshës prej 15 deri 49 vjet të cilat sjellin vendime personale dhe informative lidhur me marrëdhëniet seksuale, përdorimin e kontracëpsionit dhe kujdesin për shëndetin riprodhues.<br/> <b>5.6.2.</b> Numri i ligjeve dhe rregullativave të cilat ua garantojnë qasjen e femrave të moshës prej 15 deri 49 vjet deri te kujdesi për SHSR, edukimin dhe informatat.</p> |

6 (1994) Kajro, për herë të parë janë afirmuar të drejtat riprodhuese të individëve dhe qëllimet e vendosura për avancimin e SHSR

7 (1995) Pekin, vërtetimi i të drejtave riprodhuese të femrës dhe liria personale gjatë miratimit të vendimeve për seksualitetin

8 United Nations Economic and Social Council (2016) Report of the Inter-Agency Group on Sustainable Development Goal Indicators, <http://unstats.un.org/unsd/statcom/47th-session/documents/2016-2-IAEG-SDGs-Rev1-E.pdf>

## Shëndeti seksual dhe riprodhues në Strategjinë për barazi gjinore 2013 – 2020 dhe Plani aksionar nacional 2013 – 2016 dhe kontributi ndaj Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm

SHSR nuk është veçuar si prioritet i veçantë në Strategjinë për barazi gjinore. Aspektet e SHSR janë integruar në kuadër të Qëllimi specifik strategjik Qëllimi 2.4 Shëndetësia<sup>9</sup> përmes disa aktiviteteve, por nuk janë veçuar si rezultatet specifike. Një pjesë e madhe e aktiviteteve të cilat drejtpërdrejt kanë të bëjnë me SHSR janë përfshirë vetëm në Rezultatin 210, derisa në Rezultatin 111 mungon lidhshmëria e drejtpërdrejtë me SHSR, edhe pse në mënyrë indirekte do të mund të kontribuohet drejt përmirësimit të sistemit të grumbullimit dhe raportimi në pikëpamje të avancimit të barazisë gjinore, por vetëm nëse masat e planifikuara zbatohen.

Të gjithë indikatorët nga Rezultati 1 i PAN, (1) janë përgatitur formularë të ri për raportim për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore, (2) janë përgatitur programe softueri për vëzhgimin e sëmundjeve dhe (3) janë realizuar trajnime për shfrytëzimin e formularëve të ri në mbrojtjen primare shëndetësore, do të mund të ishin të lidhura fuqishëm me indikatorët për SHSR nga detyrat 3.1 dhe 3.7 dhe të kontribuojnë drejt QZHQ. Por, për këtë është e nevojshme përfshirja e indikatorëve specifik me interes për SHSR në PAN të ardhshme dhe integrimi i informatave të SHSR në formularët e ri për raportim dhe programet softuerë për përpunimin e të dhënave. Po ashtu, informatat e SHSR duhet të ndahen në më shumë baza (gjini, moshë, kufizime, të ardhura, përkatësia etnike, statusi i emigrantëve/refugjatëve), ndërsa trajnimet për shfrytëzimin e formularëve të ri të përhapen edhe te punëtorët shëndetësorë nga mbrojtja sekondare dhe terciare shëndetësore.

Nga ana tjetër shumica e indikatorëve nga Rezultati 1 nga PAN janë në lidhshmëri të drejtpërdrejtë me detyrat 3.1. dhe 3.7, por ato vetëm në masë të vogël do të mund të kontribuojnë drejt detyrave 3.1, 3.7 dhe 5.6 nga QZHQ:

9 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (2013) Plani nacional për barazi gjinore 2013 - 2016, <http://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nsp>

10 Ngritja e cilësisë dhe arritja deri te shërbimet shëndetësore për meshkujt dhe femrat

11 Vendosja e metodologjisë barazuese për grumbullimin e informatave për të gjitha llojet e sëmundjeve të meshkujve dhe femrave dhe për shërbimet e shfrytëzuara shëndetësore

1. Janë zbatuar 3 fushata informative në nivel vjetor, debate publike dhe promovime me materiale edukative me qëllim të avancimit të shëndetit meshkujve dhe femrave për gjendjet më të shpeshta lidhur me morbiditetin;
2. Janë zbatuar kontrole parandaluese për zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje
3. Janë zbatuar 10 sesione edukative në nivel vjetor për fëmijët shkollor dhe adoleshentët, femrat nga mjediset urbane dhe rurale
4. Është zbatuar hulumtim dhe është përgatitur raport për njohuritë, shkathtësitë dhe praktika e femrës rome për avancimin e shëndetit seksual dhe riprodhues

Në të vërtetë, në PAN mungojnë fushata të veçanta informative ose kontrole parandaluese të cilat janë me interes specifik për SHSR. Po ashtu janë të pamjaftueshme ose mungojnë masat për promovim gjithëpërfshirës, edukimin dhe mbrojtjen e të drejtave riprodhuese dhe seksuale të femrës në PAN, si dhe hulumtimet të cilat do të përhapen edhe te grupet tjera të rrezikuara (jo vetëm te popullata rome) që avancimi i strategjisë dhe aktivitetet nga plani aksionar drejt indikatorëve SHSR nga detyrat 3.1, 3.7 dhe 5.6 nga QZHQ të jetë në nivel të kënaqshëm.

Po ashtu një nga indikatorët nga Rezultati 2, (5) Numri i rritur i gjinekologëve në mbrojtjen primare shëndetësore për shkak të qasjes më të mirë të shërbimeve shëndetësore, do të mund të kontribuonin në mënyrë të rëndësishme drejt detyrave 3.1, 3.7 dhe 5.6 nga QZHQ, por në planet aksionare mungojnë masat dhe aktivitetet konkrete që në mënyrë më konkrete do të mund të siguronin mjek-gjinekologë sipas normativit të dhënë<sup>12</sup>. Po ashtu, masat kanë të bëjnë vetëm me institucionet për mbrojtje primare shëndetësore, por jo edhe në mbrojtjen sekondare dhe terciare shëndetësore, me çka kontributi nga strategjia dhe planet aksionare drejt detyrave 3.1 dhe 3.7 nga QZHQ është i kufizuar.

Mungesa e SHSR si rezultat i veçantë specifik, njëlloj si në SBGJ dhe PAN, krijon vështirësi për vëzhgimin e kontributit të shtetit drejt detyrave nga QZHQ, të cilat kanë rëndësi për SHSR njëkohësisht edhe në avancimin e barazisë gjinore. Edhe pse disa nga aktivitetet në PAN janë të lidhura me aspektet e SHSR, megjithatë kjo nuk është e nevojshme pasi që mungesa e qëllimeve konkrete do ta zvogëlonte

12 1 ekipi i 3000 femrave >15 vjet, në pajtim me Rrjetin për institucione shëndetësore në Republikën e Maqedonisë

rëndësinë e SHSR në planifikimet operative nga perspektiva gjinore dhe lidhshmëria e tyre me QZHQ. Po ashtu, një numër i madh i indikatorëve nga PAN janë pikënisje solide e cila më tej do të kontribuonte drejt detyrave të QZHQ, të cilat kanë rëndësi për SHSR dhe barazinë gjinore, por nevojitet që indikatorët në PAN të specifikohen për SGHSR në përfshirjen e gjerë.

## **Në cilën masë informatat nacionale dhe statistika për SHSR janë të mjaftueshme për vëzhgimin dhe raportimin ndaj QZHQ**

Instituti për shëndet publik (ISHP) dhe Enti për mbrojtje shëndetësore të nënave dhe fëmijëve (EMSHNF) mban evidencë për vëzhgimin e indikatorëve 3.1.113. Megjithatë mungojnë të dhëna të ndara për më shumë karakteristika demografike dhe socio-ekonomike (përkatësia etnike, vendbanimi, të ardhurat etj.) si dhe për shkaqet e vdekshmërisë të nënat. Brengos edhe azhurnimi i vonuar i të dhënave. Të dhënat e fundit zyrtare për vdekshmërinë e nënave ka të bëjë me vitin 2013.14

EMSHNF mban evidencë për numrin e foshnjave të lindura të gjalla me ndihmë profesionale, gjegjësisht për indikatorin 3.1.215. Megjithatë, raportet vjetore të EMSHNF nuk janë të kapshme në format elektronik, ndërsa në raportet për Shëndetin e popullatës në ISHP këto të dhëna mungojnë.

Për indikatorin 5.6.116 shfrytëzohen për SHSR në studimet nacionale të cilat i hulumtojnë njohuritë, shprehitë dhe sjelljet në funksion të mbrojtjes së shëndetit. Kështu në studimin bio-bioheviroal të rinjtë dhe popullatat me rrezik të madh nga infektimi HIV17 analizohen trendët e njohurisë dhe praktikat të grupet e ndryshme qëllimore në korrelacion me rrezikun nga transferimi i HIV ose infektimet seksualisht të transferueshme, derisa në hulumtimin për shëndetin e adoleshentëve 18 sigurohen të dhëna për shprehitë dhe sjelljet lidhur me shëndetin dhe faktorët mbrojtës të nxënësit me qëllim të vlerësimit të promovimit shëndetësor të rinjtë dhe në shkollë. Të dhënat nuk janë ndarë sa duhet, e as nuk tregojnë sa femrat janë të pavarura gjatë vendimmarrjeve për SHSR të vet, që nga ana tjetër janë mjaft të rëndësishme që të tregojnë për lidhshmërinë për kujdesin e SHSR nga

13 Vdekshmëria e nënave në 100.000 lindje

14 Instituti për shëndet publik (2014) Raport për shëndetin e popullatës në Republikën e Maqedonisë, <http://iph.mk/wp-content/uploads/2015/03/Spoen-izvestaj-novo-so-sodrzina-i-naslovna-so-CIP.pdf>

15 Përqindja e lindjeve nga kadri profesional-shëndetësor

16 Përqindja e femrave të moshës prej 15 deri 49 vjet të cilat sjellin vendime personale dhe informative lidhur me marrëdhëniet seksuale, përdorimi i kontracesionit dhe kujdesi për shëndetin riprodhues

17 Ministria e Shëndetësisë dhe Enti republikan për mbrojtje shëndetësore (2008) Raporti për studimin bio-bioheviroal për të rinjtë dhe popullatat me rrezik më të madh ndaj HIV infektimit në Republikën e Maqedonisë në vitin 2006, [http://www.unicef.org/tfyrmacedonia/MK\\_BehavioralStudy\\_MK2006.pdf](http://www.unicef.org/tfyrmacedonia/MK_BehavioralStudy_MK2006.pdf)

18 Enti republikan për mbrojtje shëndetësore (2008) Hulumtimi global për shëndetin e adoleshentëve në Republikën e Maqedonisë, [http://www.unicef.org/tfyrmacedonia/SchoolBasedHealthSurvey\\_\\_Macedonian.pdf](http://www.unicef.org/tfyrmacedonia/SchoolBasedHealthSurvey__Macedonian.pdf)

aspekti gjinor. Për shembull, kontracepsioni ka të bëjë me fitimin e informatave sa ai përdoret te të rinjtë, cilat tipa të mjeteve kontraceptive përdoren dhe çfarë njohurish kanë, por nuk ka të dhëna nëse vendimi për shfrytëzimin është me zgjedhje personale ose e detyruar nga partneri që të hulumtohen edhe aspektet gjinore.

Informata e vetme e disponueshme që përdoret për raportim periodik të indikatorit 3.7.219 është Hulumtimi i klasterit multi-indikatorëve që është zbatuar në vitin 2007 dhe pastaj në vitin 2011 nga ana e UNICEF dhe ISHP20. Hulumtimi ofron të dhëna të ndara mbi më shumë baza, gjegjësisht metoda e kontracepsionit, rajonet, fushat, moshë, të ardhurat, statusi i martesës, prejardhja etnike. Megjithatë, minimum standardet me të cilat mund të vlerësohet trendi i përdorimit të kontracepsionit janë dhënë në dy hulumtimet nacionale reprezentative<sup>21</sup>. Po ashtu EMSHNF posedon statistika për numër të mjeteve ordinere kontraceptive si e dhënë përmes së cilës vëzhgohet qasja deri te serviset shëndetësore për planifikim të familjes<sup>22</sup>. Megjithatë këto të dhëna mundësojnë vetëm të përcillen trendët vjetor të metodave kontraceptive ordinere në mbrojtjen primare shëndetësore, por të dhënat nuk janë ndarë sipas karakteristikave socio-ekonomike dhe demografike, e as nuk mbahet statistikë e hollësishme e metodave për kontracepsion.

Enti shtetëror për statistikë mban evidencë për indikatorët 3.7.223 dhe atë në përgjithësi për lindjet te popullata adoleshente nën moshën 15 vjeçare dhe të ndara për çdo vit, prej 15 deri 19 vjet<sup>24</sup>. Megjithatë, raportet statistikore vjetore nuk mbajnë të dhëna të veçanta për numrin e lindjeve mbi baza tjera, duke përfshirë për shembullin përkatësinë etnike dhe të ardhurat me çka do të fitohej pasqyrë më e mirë për karakteristikat tjera socio-ekonomike dhe demografike për shtatzëninë adoleshente.

19 Përqindja e femrave në periudhën riprodhuese (15-49) nevojat e të cilave për planifikim familjar janë të kënaqura me kontracepsion modern

20 MULTIPLE indicator cluster survey (2011) Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, [http://www.unicef.org/tfymacedonia/MICS\\_ENG\\_FINAL\\_websize.pdf](http://www.unicef.org/tfymacedonia/MICS_ENG_FINAL_websize.pdf)

21 United Nations (2015) Trends in Contraceptive Use Worldwide 2015, <http://www.un.org/en/development/desa/population/publications/pdf/family/trendsContraceptiveUse2015Report.pdf>

22 INFORMATË Shëndeti i nënave dhe fëmijëve në Republikën e Maqedonisë në vitin 2014, ISHP "Shtëpia e shëndetit Shkup" – Shkup, shtator 2015

23 Shkalla e lindjeve te adoleshentet (të moshës prej 10 – 14 dhe 15 – 19 vjet) në 1000 femra në grup moshën e njëjtë

24 Enti shtetëror për statistikë (2014) Libri vjetor statistikor i Republikës së Maqedonisë, Kategoria Popullata, <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/PDFS-G2014/03-Naselenie-Population.pdf>

## Rekomandime

1. Gjatë revizionit të Strategjisë për barazi gjinore dhe përgatitja e planeve aksionare, në Qëllimin strategjik: Shëndetësia të inkuadrojë rezultat të veçantë që ka të bëjë vetëm me SHSR si aspekt i rëndësishëm shëndetësor në avancimin e barazisë gjinore

2. Gjatë përgatitjes së planeve operative për barazinë gjinore të përfshihen masat gjithëpërfshirëse për SHSR të cilat drejtpërdrejtë kontribuojnë drejt përmbushjes së Qëllimit nr. 3 dhe 5 nga QZHQ, gjegjësisht aktivitete të cilat kanë për qëllim zvogëlimin e vdekshmërisë së nënave dhe shtatzënia adoleshente, rritja e përdorimit të kontracepsionit, si dhe intervenimi për forcimin e femrave për të drejtat riprodhuese. Po ashtu, në planet operative të përfshihen analizat e ligjeve dhe rregulloret të cilat do t'i ndjekin trendët rreth qasjes deri te shërbimet dhe respektimi i të drejtave riprodhuese.

3. Indikatorët që vijnë për SHSR është e nevojshme të grumbullohen, analizohen dhe të raportet për ato në nivel nacional që t'u përgjigjet nevojave të QZHQ nga aspekti i barazisë gjinore, por edhe të përfshihen gjatë përgatitjes së Raportit vjetor për avancimin e gjendjes së mundësive të barabarta të femrave dhe meshkujve:

|                         |   |
|-------------------------|---|
| <b>Indikator 3.1.1.</b> | Vdekshmëria e nënave në 100.000 lindje. |
|-------------------------|---|

|                         |  |
|-------------------------|--|
| <b>Indikator 3.1.2.</b> | % e lindjeve nga kuadri profesional-shëndetësor. |
|-------------------------|--|

|                         |   |
|-------------------------|---|
| <b>Indikator 5.6.1.</b> | % e femrave të moshës prej 15 deri 49 vjet të cilat sjellin vendime personale dhe të informuar për marrëdhëniet seksuale, përdorimi i kontracepsionit dhe kujdesi për shëndetin riprodhues. |
|-------------------------|---|

|                         |  |
|-------------------------|--|
| <b>Indikator 5.6.2.</b> | Numri i ligjeve dhe rregulloreve të cilat ua garantojnë qasjen e grave të moshës prej 15 deri 49 vjet deri te kujdesi për SHSR, edukimi dhe informatave. |
|-------------------------|--|

|                         |   |
|-------------------------|---|
| <b>Indikator 3.7.1.</b> | Përqindja e femrave në periudhën riprodhuese (15-49) nevojat e të cilave për planifikimin familjar janë të kënaqura me kontracepsionit modrn. |
|-------------------------|---|

|                         |   |
|-------------------------|---|
| <b>Indikator 3.7.2.</b> | Shkalla e lindjeve te adoleshentet (e moshës prej 10 – 14 dhe 15 – 19 vjet) në 1000 femra në grupin e njëjtë të moshës. |
|-------------------------|---|

4. Të bëhen revizione të formularëve për grumbullimin e të dhënave shëndetësore, me të cilat do të mundësohet dispozicioni me të dhëna më të mëdha të veçanta, e me këtë edhe vëzhgimi më i mirë i SHSR në plotësimin e QZHQ dhe barazinë gjinore, gjegjësisht:

- Informata të veçanta për vdekshmërinë materniale (përkatësia etnike, të ardhurat, mosha, vendbanimi – fshat/qytet etj.) dhe shkaqet e vdekshmërisë
- Informata të veçanta për numrin e mjeteve kontraceptive ordinere (sipas metodës të kontracepsionit, përkatësisë etnike, arsimimi, mosha, vendbanimi – fshat/qytet etj.)
- Informata të veçanta për shkallën e shtatzënisë adoleshente (përkatësia etnike, të ardhurat, arsimimi, mosha, vendbanimi – fshat/qytet etj.)

## FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE DHE VAJZAVE DHE QËLLIMET PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Fuqizimi ekonomik i femrës paraqet një nga parakushtet kryesore për avancimin e barazisë gjinore. Pjesëmarrja e ulët në tregun e punës, hendeku gjinor në rroga, puna e papranuar shtëpiake, si dhe qasja e kufizuar deri te resurset dhe pozitat udhëheqëse janë faktorët kryesor të cilët nuk e mundësojnë realizimin e potencialit të tërësishëm të grave dhe vajzave dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në të gjitha sferat shoqërore.

AZHQ e trajton barazinë gjinore nga shumë aspekte, gjegjësisht përfshinë qëllime dhe detyra në fusha të ndryshme me plotësimin e të cilit pritet të përmirësohet pozita ekonomike e femrës. Në kontekst të barazisë gjinore në Republikën e Maqedonisë, veçanërisht në pikëpamje të fuqizimit ekonomik të femrës, disa qëllime dhe detyra nga AZHQ mund të ndahen si më relevante dhe janë lëndë e kësaj analize. Qëllimi 5 i cili i përkushtohet arritjes së barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave dhe vajzave përfshinë dy detyra (5.4 dhe 5.a) të cilat kanë të bëjnë me avancimin e pozitës së tregut të punës dhe në marrëdhëniet ekonomike. Në mënyrë plotësuese, AZHQ përmes qëllimit 8 dhe detyrës 8.5 synon drejt arritjes së punësimit të plotë dhe produktiv dhe punës me dinjitet për të gjitha femrat dhe meshkujt, si dhe rrogë e njëjtë për punë të njëjtë, me çka në mënyrë të drejtpërdrejtë do të kontribuojë drejt përmirësimit të pozitës ekonomike të femrës. Qëllimet e cekura kanë të blejnë me fuqizimin ekonomik të femrës dhe do ta matin dhe vlerësojnë punën e papaguar shtëpiake, shkallën e promovimit të shpërndarjes së obligimeve shtëpiake, shkallën e reformave të zbatuara të cilat do t'u japin të drejta të barabarta dhe qasje femrës drejt resurseve ekonomike, qasje deri te pronësia dhe kontrolli mbi tokën dhe format tjera të pronës, shërbime financiare, trashëgimi dhe resurse natyrore, varësisht nga ligjet nacionale. Krahas këtyre, ndërsa të lidhura në mënyrë indirekte me pozitën ekonomike të femrës, e me këtë edhe barazia, me qëllimet për çrrënjosjen e varfërisë në të gjitha format e saja (1ëllimi 1), çrrënjosja e urisë dhe arritja e sigurisë së ushqimit, ushqimi më i mirë dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme

(qëllimi 2) dhe zvogëlimi i pabarazisë në shtetet dhe mes tyre (qëllimi 10).

Indikatorët primar për vëzhgimin e qëllimeve për fuqizimin ekonomik të femrës në AZHQ janë prezantuar në tabelën 2. Grumbullimi i të dhënave të domosdoshme për vëzhgimin e indikatorëve, me të cilët do të matet fuqizimi ekonomik i femrës duhet të zhvillohet përmes anketave të ndryshme të amvisërive (household survey), Anketa për shfrytëzimin e kohës dhe Anketa për fuqinë e punës.

**TABELA 2:** Fuqizimi ekonomik i femrës në Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm

| <b>Detyrat</b>  | <b>Indikatorët</b>  |
|---|---|
| <p><b>5.4</b> Njohja dhe vlerësimi i punës së papaguar shtëpiake (kujdesi për fëmijët, pleqtë dhe personat me nevoja të veçanta), përmes sigurimit të shërbimeve publike, infrastrukturës dhe politikave për mbrojtje sociale dhe promovimi i shpërndarjes së obligimeve në familje.</p>      | <p><b>5.4.1</b> Përqindja e kohës së kaluar në punën e papaguar shtëpiake dhe kujdesin (për fëmijët, pleqtë dhe personat me nevoja të veçanta) sipas gjinisë, moshës dhe lokacionit.</p>  |
| <p><b>5.a</b> Zbatimi i reformave të cilat do t'u japin femrave të drejta të barabarta drejt resurseve ekonomike, dhe qasje deri te pronësia dhe kontrolli mbi tokën dhe format tjera të pronës, shërbimet financiare, trashëgimia dhe resurset natyrore, varësisht nga ligjet nacionale.</p> | <p><b>5.a.1</b> (a) Përqindja e qytetarëve me pronësi ose të drejta mbi tokën bujqësore dhe format tjera të pronës, shërbimeve financiare, trashëgimia dhe resurset natyrore, varësisht nga ligjet nacionale. Përqindja e qytetarëve me pronësi ose sigurimi i të drejtave mbi tokën bujqësore (nga popullata e përgjithshme bujqësore), sipas gjinisë; dhe (b) pjesëmarrja e femrës mes pronarëve ose bartësit e të drejtës për tokë bujqësore, sipas llojit të pronësisë.</p> <p><b>5.a.2</b> Përqindja e tokës ku korniza ligjore (duke përfshirë të drejtën tradicionale), garanton të drejta të barabarta për femrën për pronësinë e tokës dhe/ose kontroll mbi tokën.</p> |
| <p><b>Qëllimi 8.5</b> Deri në vitin 2030 të arrihet punësimi i plotë dhe produktiv dhe punë me dinjitet për të gjitha femrat dhe meshkujt, duke përfshirë edhe të rinjtë dhe personat me nevoja të veçanta, si dhe rrogë e barabartë për punë të njëjtë.</p>                                  | <p><b>8.5.1</b> Të ardhurat mesatare (në orë) të femrave dhe meshkujve të punësuar, sipas profesionit, moshës dhe nevojave të veçanta (personat me nevoja të veçanta)</p> <p><b>8.5.2</b> Përqindja e papunësisë, të ndara sipas gjinisë, moshës dhe nevojave të veçanta (personat me nevoja të veçanta)</p>  |



## Fuqizimi ekonomik i femrës në Strategjinë për barazi gjinore 2013 – 2020 dhe Plani aksionar 2013 – 2016 dhe kontributi ndaj Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm

Fuqizimi ekonomik i femrës është një nga prioritetet e Strategjisë për barazi gjinore. Qëllimi specifik strategjik 2.3 parasheh: Politika të vendosura dhe pilot për tejkalimin e barrierave/pengesave dhe punësimi i rritur i femrës (balancimi i jetës private/profesionale, sipërmarrësia e femrës, diskriminimi i tregut të punës). Përmes qëllimit specifik strategjik 2.3 pritet të arrihen rezultatet që vijojnë:

1. Masa dhe politika të avancuara ligjore për harmonizimin e jetës private dhe profesionale;
2. Qasje dhe kushte të përmirësuara për femrat në fillimin dhe zhvillimin e sipërmarrësisë;
3. Qasje e përmirësuar e femrës drejt politikave për punësim;
4. Eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit mbi baza të gjinisë në tregun e punës.

Qëllimi strategjik i këtillë i vendosur ka lidhshmëri të rëndësishme me AZHQ në pjesën e fuqizimit ekonomik të femrës, ndërsa rezultatet nga SBGJ më së shumti kontribuojnë drejt detyrave 5.4 dhe 8.5, derisa kontributi drejt detyrës 5.1 është i kufizuar. Strategjia njeh se femrat në pjesën më të madhe janë inkuadruar në punën e papaguar shtëpiake dhe prej këtu në PAN është paraparë vendosja e masave dhe aktiviteteve për balancimin e jetës private dhe publike, si dhe promovimi i orarit të shkurtuar të punës në kombinim me shpërndarjen e obligimeve në familje për kujdesinë fëmijëve dhe pleqve dhe personave me nevoja të veçanta.

Rezultati 1 është në korrelacion me detyrat 5.4 dhe 8.5 të QZHQ pasi që për plotësimin e tij janë paraparë aktivitete, gjegjësisht masa dhe politika të cilat kontribuojnë për balancimin e jetës private dhe profesionale, mbrojtja nga diskriminimi, shërbime të përmirësuara sociale dhe infrastruktura dhe përmes kësaj qasje e lehtësuar deri te tregu i punës. Nga analiza del se indikatorët për matjen e suksesit të masave dhe aktiviteteve nga PAN të orientuara drejt rezultatit 1, edhe pse janë të definuara qartë, në pjesën më të madhe nuk mundësojnë vlerësim gjithëpërfshirës dhe cilësor të ndikimit të aktiviteteve dhe efektit të tyre në drejtim të arritjes së rezultateve. Një pjesë e indikatorëve nga PAN (numri i trajnimeve të realizuara, numri i hulumtimeve të zbatuara, numri i ngjarjeve të organizuara etj.) nuk mund të kontribuojnë në mënyrë thelbësore për fuqizimin ekonomik të femrës në pajtim me detyrat 5.4, 5.1 dhe 8.5. Në mënyrë plotësuese, masat kështu të dizajnuara, si dhe indikatorët adekuat, nuk do të mundësonin të dhëna relevante me të cilat do të mund të vëzhgohet indikator

5.4.1 nga QZHQ. Megjithatë, indikatorët Vlerësimi i kapaciteteve të forcuara, Rastet e caktuara të diskriminimit nga ana e inspektoratit të punës, Tipi i masave të ndërmarra dhe Numri i institucioneve të sapo hapura mundësojnë vlerësim të cilësisë dhe ndikimit të aktiviteteve.

SBGJ dhe PAN në masë të vogël janë të lidhura me detyrat 5.a nga QZHQ pasi që mungojnë masa konkrete dhe aktivitete të cilat do të siguronin qasje të barabartë dhe të drejta të femrave në pikëpamje të qasjes deri te resurset. Fuqizimi ekonomik i femrës është qëllim prioritar, ndërsa përmes realizimit të rezultateve, gjegjësisht zbatimit të aktiviteteve do të mund të fuqizohet lidhshmëria me detyrën 5.a. Në të vërtetë, aktivitetet lidhur me rezultatin 2 nga PAN janë orientuar drejt zhvillimit dhe promovimit të sipërmarrësisë së femrave dhe realizimit të tyre të suksesshëm, edhe ose në vëllim të kufizuar, do të mund ta përmirësojë qasjen deri te resurset ekonomike. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se asnjë SBGJ dhe PAN nuk e njohin qasjen e kufizuar deri te pronësia, kontrolli mbi tokën dhe llojet tjera të pronës, si problem i cili duhet të adresohet që të avancohet pozita ekonomike e femrës dhe për këtë shkak nuk parashohin masa dhe aktivitete të drejtuara nga detyra 5.a.

Rezultatet 3 dhe 4 janë në korrelacion me QZHQ pasi që arritja e tyre mund të kontribuojë drejt zvogëlimit të diskriminimit të tregut të punës dhe rritja e punësimit, por aktivitetet e parapara nuk e adresojnë hendekun gjinor të rrogat. Më saktë, masat dhe aktivitetet për arritjen e rezultateve të cekura parashohin identifikimin e shkaqeve për pjesëmarrjen e ulët të femrës në tregun e punës dhe shkaqet dhe format e diskriminimit gjinor, forcimin e bashkëpunimit institucional dhe kapacitetet, si dhe zhvillimi dhe implementimi i politikave dhe masave, me të cilat do të rritet pjesëmarrja e femrës në tregun e punës dhe do të zvogëlohet diskriminimi në sektorin publik dhe privat. Megjithatë, me SBGJ dhe PAN është e domosdoshme në përgjithësi të adresohet hendeku gjinor në rrogat që të arrihet kontribut më i madh drejt detyrës 8.5.

Indikatorët të cilët kanë të bëjnë me përmirësimin e qasjes së femrës drejt politikave për punësim (Rezultati 3) janë definuar qartë dhe kanë lidhshmëri me detyrat relevante nga QZHQ dhe mundësojnë matjen e ndikimit, gjegjësisht ndikimin e aktiviteteve. Por, në të njëjtën kohë nuk mund të thuhet lidhur me indikatorët lidhur me eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit mbi bazë të gjinisë në tregun e punës (Rezultati 4). Kështu të vendosura, indikatorët nuk mundësojnë të dhëna për cilësinë dhe ndikimin e aktiviteteve dhe kontributin e tyre në realizimin e rezultatit konkret.

## Në cilën masë të dhënat nacionale dhe statistikat për SHSR janë të mjaftueshme për vëzhgimin dhe raportimin drejt QZHQ

Indikatori 5.4.125 pjesërisht mund të vëzhgohet përmes Anketës për shfrytëzimin e kohës që Enti shtetëror për statistikë e ka zbatuar çdo pesë vjet. Kjo anketë e tregon shpërndarjen gjinore të kohës së kaluar në obligimet shtëpiake, ndërsa të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe tregojnë se femrat në pjesën më të madhe kujdesen për obligimet shtëpiake dhe fëmijët, pa dallim nëse janë të punësuar, të papunësuar ose jo aktive në tregun e punës. Të dhënat nga anketa janë ndarë sipas kohës, gjinisë, moshës, dhe statusit bashkëshortor, por nuk e tregojnë lokacionin e të anketuarve, përkatësinë e tyre etnike dhe të ardhurat<sup>26</sup>, siç është paraparë me indikatorin.

Agjencia për kadastër dhe patundshmëri është institucioni shtetëror kompetent që disponon me të dhëna relevante për vëzhgimin e Indikatorit 5.a.1.27. Edhe pse i disponon të dhënat për vlerësimin e pronësisë ose të drejtën në pronë (patundshmëri) dhe tokën për përpunim të ndara sipas gjinisë, Agjencia nuk i publikon këto të dhëna në ueb faqen e vet.

Indikatori 5.a.228 për detyrën 5a po ashtu mund të vëzhgohet pasi që nënkupton vlerësim të kornizës juridike e cila e rregullon pronësinë. Sipas parimit të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë qytetarët kanë të drejtë për pronësi dhe të drejtë për trashëgimi dhe “askujt nuk mund t’i merren ose t’i kufizohen pronësia dhe të drejtat që dalin nga ajo, përveç nëse bëhet fjalë për interes publik të caktuar me ligj”. Në rast të ekspropriacionit të pronësisë ose në rast të kufizimit të pronësisë garantohet kompensim i drejtë, i cili nuk mund të jetë më i ulët nga vlera në treg.”<sup>29</sup> Në këtë kontekst, mund të thuhet se juridikisht nuk ekzistojnë ligje të cilat e kufizojnë të drejtën e pronësisë së femrës. Megjithatë, është indikativ fakti se vetëm një e treta e pronarëve të tokës bujqësore dhe patundshmërisë janë femra. Ai tregon se mungesat potenciale në implementimin e rregullores, si dhe e nevojës nga hulumtime plotësuese me të cilat do të identifikoheshin shkaqet për hendekun e madh gjinor në pronësinë e tokës.

25 Përqindja e kohës së shpenzuar për punën e papaguar shtëpiake (dhe kujdesi) e ndarë sipas gjinisë, moshës dhe lokacionit.

26 Enti shtetëror për statistikë (2015). Anketa për shfrytëzimin e kohës 2014/2015, <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.15.20.pdf>

27 Përqindja e qytetarëve me pronësi ose të drejta mbi tokën bujqësore dhe format tjera të pronës, shërbime financiare, trashëgimia dhe resurset natyrore, varësisht nga ligjet nacionale. Përqindja e qytetarëve me pronësi ose sigurimin e të drejtës mbi tokën bujqësore (nga popullata e përgjithshme bujqësore), sipas gjinisë; dhe (b) pjesëmarrja e femrës mes pronarëve ose bartësve të drejtës për tokë bujqësore, sipas tipit të pronësisë.

28 Përqindja e vendeve ku korniza juridike (duke përfshirë të drejtën tradicionale), garanton të drejta të barabarta të femrës mbi pronësinë e tokës dhe/ose kontroll mbi tokën.

29 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (1991) Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, Neni 30, <http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspk>

Indikator 8.5.130 për përmbushjen e qëllimit 8.5 është pjesërisht i matshëm përmes të dhënave ekzistuese të ESHS. Nga ana e ESHS janë publikuar disa publikime<sup>31</sup> ku janë përfshirë të ardhurat mesatare sipas asaj se sa femrat dhe meshkujt paguhen në orë, e gjithashtu nuk ka të dhëna për personat me nevoja të veçanta. Nga ana tjetër, hulumtimet tregojnë se femrat nga pakicat etnike do të punonin për të ardhura më të ulëta<sup>32</sup> dhe prej këtu del rëndësia e ESHS të grumbullojë dhe klasifikojë të dhënat për punësimin dhe të ardhurat e femrave nga pakicat etnike. Shkalla e punësimit dhe të ardhurat duhet të shpërndahen edhe sipas komunave me qëllim të identifikimit të mjediseve lokale ku nevojiten masa plotësuese dhe politika për stimulim të aktivitetit ekonomik të femrës.

Indikator 8.5.2 pothuaj tërësisht mund të vëzhgohet dhe ESHS disponon me të dhëna për përqindjen e punësimit, të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përveç për personat me nevoja të veçanta. Agjencia për punësim rregullisht grumbullon dhe azhurnon të dhëna për personat e papunësuar sipas përkatësisë etnike, moshës dhe gjinisë, duke përfshirë edhe pasqyrë të personave të papunësuar invalidë (personat me nevoja të veçanta) sipas strukturës së moshës, shkallës së arsimit dhe llojit të invaliditetit.

---

30 Të ardhurat mesatare (në orë) të femrave dhe meshkujve të punësuar, sipas profesionit, moshës dhe nevojave të veçanta (personat me nevoja të veçanta).  
31 Enti shtetëror për statistikë (2014). Të punësuar dhe neto rroga, <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.15.05.pdf>  
32 Reaktor – Hulumtimi në aksion (2010). Gratë në ekonominë maqedonase, <http://www.reaktor.org.mk/CMS/Files/Publications/Documents/Nacionalna%20-%20mak%20FINAL.pdf>

## Rekomandime

1. Për vëzhgimin e avancimit të shtetit në pikëpamje të barazisë gjinore indikatorët që vijnë për fuqizimin ekonomik, që janë rekomanduar nga QZHQ nevojitet të grumbullohen dhe të analizohen në kuadër të mekanizmave nacional për raportim, si dhe të përfshihen gjatë përgatitjes së Raportit vjetor për avancimin e gjendjes së mundësive të barabarta të femrës dhe mashkullit:

**Indikatori 5.4.1.** Përqindja e kohës së kaluar në punë të papaguar shtëpiake dhe kujdes (për fëmijët, pleqtë dhe personat me nevoja të veçanta) sipas gjinisë, moshës dhe lokacionit

**Indikatori 5.a.1.** Përqindja e qytetarëve me pronësi ose të drejta mbi tokën bujqësore dhe format tjera të pronës, shërbimet financiare, trashëgimisë dhe resurseve natyrore, varësisht nga ligjet nacionale. Përqindja e qytetarëve me pronësi ose sigurimi i të drejtave mbi tokën bujqësore (nga popullata e përgjithshme bujqësore), sipas gjinisë; dhe (b) pjesëmarrja e femrës mes pronarëve ose bartësve të drejtës për tokë bujqësore, sipas tipit të pronësisë.

**Indikatori 5.a.2.** Përqindja e tokës ku korniza juridike (duke përfshirë të drejtën tradicionale), garanton të drejta të barabarta të femrës mbi pronën e tokës dhe/ose kontroll mbi tokën

**Indikatori 8.5.1.** Të ardhurat mujore (në orë) të femrave dhe meshkujve të punësuar, sipas profesionit, moshës dhe nevojave të veçanta (personat me nevoja të veçanta)

**Indikatori 8.5.2.** Përqindja e papunësisë, të ndara sipas gjinisë, moshës dhe nevojave të veçanta (personat me nevoja të veçanta)

2. PAN i ri të parashohë aktivitete për fuqizimin ekonomik të femrës të cilat janë relevante për Qëllimin nr.5 të QZHQ, gjegjësisht aktivitete për njohjen dhe vlerësimin e punës së papaguar shtëpiake, zbatimin e masave të cilat do t'u japin të drejta të barabarta femrës ndaj resurseve ekonomike, pronësisë dhe kontroll mbi tokën dhe punësim të tërësishëm dhe produktiv dhe punë me dinjitet për të gjitha femrat dhe meshkujt.

3. Enti shtetëror statistikor rregullisht të bëjë grumbullimin e të dhënave për të ardhurat e femrave dhe meshkujve të ndara sipas orës, komunës dhe përkatësisë etnike. Të dhënat plotësuese në Anketën

për shfrytëzimin e kohës të ndahet edhe sipas kriterëve tjerë të parapara me QZHQ siç janë lokacioni i të anketuarve, përkatësia etnike, kufizimet dhe të ardhurat e të anketuarve.

4. Të forcohen kapacitetet e Agjencisë për kadastër dhe të vendoset azhurnimi i rregullt i data bazës me të dhënat për gjendjen pronësore të femrave dhe meshkujve në Republikën e Maqedonisë.

## **PJESËMARRJA POLITIKE E FEMRAVE/INKUADRIMI I FEMRËS NË VENDIMMARRJE DHE QËLLIMET PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM**

Përfshirja politike e femrës është e drejta themelore e njeriut e garantuar me Deklaratën universale për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara, Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit dhe Platforma për aksion e Pekinit. Instrumentet ndërkombëtare i njohin barrierat e ndryshme të cilat ndikojnë mbi shkallën e pjesëmarrjes politike të femrës dhe presin nga vendet anëtare vendosjen e masave dhe mekanizmave për barazimin e pjesëmarrjes politike mes femrave dhe meshkujve. Sipas studime të shumta, më e sigurt është që femrat t'i mbështesin ligjet dhe masat të cilat e avancojnë barazinë, e përmirësojnë statusin e femrave, programet sociale, arsimin dhe shëndetësinë<sup>33</sup>. Hulumtimet në Maqedoni, vërtetojnë se femrat këshilltare u japin prioritet më të madh çështjeve lidhur me shëndetësinë, çështjet sociale, arsimin dhe investimet në infrastrukturën sociale.<sup>34</sup> Megjithatë, përfshirja e femrës në politikë dhe në funksione udhëheqëse edhe më tej mbetet sfidë edhe pse janë bërë hapa të rëndësishme për avancimin e pjesëmarrjes së femrës në jetën politike, hendekun gjinor edhe më tej mbetet sfidë për funksionet kryesore politike (pozitat ministrore dhe për kryetar komune), dhe pozitat udhëheqëse në institucionet shtetërore dhe publike.

Kjo analizë do të japë vështrim mbi Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm 5 dhe 16, dhe nën qëllimet dhe indikatorët relevant, të cilët synojnë të sigurojnë pjesëmarrjen e tërësishme dhe efektive të femrës dhe mundësi të barabarta për udhëheqësi në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike. Më saktë detyra 5.5 e matë avancimin e barazisë gjinore përmes inkuadrimit politik të femrës në nivel lokal dhe nacional dhe rritjen e numrit të femrës në pozita menaxhieriale (udhëheqëse). Po ashtu, nën qëllimi 16.7 e matë avancimin e barazisë gjinore përmes vendimmarrjes

33 Wittmer, D. E., & Bouché, V. (2013). The limits of gendered leadership: Policy implications of female leadership on "women's issues". *Politics & Gender*, 9(3), 245-275.

34 Reaktor – Hulumtime në aksion (2015). Femrat në politikë: Rruga deri te funksionet politike dhe ndikimi në nivel lokal në Maqedoni, <http://bit.ly/2dM6va2>

participative, përgjegjëse dhe reprezentues në të gjitha nivelet, shpërndarjen gjinore të pozitive në institucionet publike (trupat ligjdhënëse nacionale dhe lokale, administratën publike dhe gjyqësorin) dhe përqindjen e popullatës (sipas gjinisë) të cilat besojnë se vendimmarrja është inkluzive.

Indikatorët për qëllimet janë vendosur nga Grupi ndër agjencitë dhe të ekspertëve për indikatorët për Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm në suaza të Komisionit për statistikë pranë Kombeve të Bashkuara<sup>35</sup>. Indikatorët në qëllimin 16, promovojnë shoqëri inkluzive për zhvillim të qëndrueshëm dhe qasje deri te drejtësia, ndërtimin e institucioneve efikase, me përgjegjësi dhe inkluzive për të gjithë, dhe janë të aplikueshme për barazinë gjinore dhe avancimin e përfshirjes së femrës në vendimmarrje.

Sipas UNFPA<sup>36</sup> vëzhgimi i përbushjes së qëllimeve të vendosura në nivel lokal do të jetë i suksesshëm vetëm përmes indikatorëve të cilët do të përfshihen në AZHQ. Deri më tani, si burim i të dhënave për vëzhgimin e qëllimeve të vendosura në nivel lokal është shfrytëzuar raporti i Departamentit statistikor i KB-ve, raporti për implementimin e Rezolutës 66/130 i femrave dhe pjesëmarrjes politike në Asamblenë gjeneralë të CEDAW dhe burimet qeveritare nacionale, duke i përfshirë edhe misionet e përhershme të Kombeve të Bashkuara.

Për shkak të mungesës së të dhënave krahasuese në të gjitha vendet dhe rajonet, duhet të zhvillohet metodologji e standardizuar dhe udhëzim për grumbullimin e të dhënave në nivel lokal.

---

35 <http://unstats.un.org/unsd/statcom/47th-session/documents/2016-2-IAEG-SDGs-Rev1-E.pdf>

36 Fondi për popullatë pranë Kombeve të Bashkuara (2015) Përmbledhje e meta të dhënave për indikatorët për vëzhgim global të Qëllimeve të qëndrueshme zhvillimore dhe tragetet, <http://unstats.un.org/sdgs/files/Metadata%20Compilation%20for%20SDG%20Indicators%2023%20October%202015%20Update.pdf>

## Pjesëmarrja politike e femrës/përfshirja e femrës në vendimmarrje në Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm

### Detyrat

### Indikatorët

**5.5.** Të sigurohet pjesëmarrja e tërësishme dhe efektive e femrës dhe mundësi të barabarta për udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike

**5.5.1.** Përqindja e femrës në parlament dhe në këshillat e vetëqeverisjes lokale

**5.5.2.** Përqindja e femrës në pozita menaxheriale

**16.7.** Të sigurohet vendimmarrje me përgjegjësi, inkluzive, participative dhe reprezentues në të gjitha nivelet

**16.7.1.** Përqindja e pozitave (sipas gjinisë, moshës, personat me nevoja të veçanta dhe grupet e popullatës) në institucionet publike (trupat nacionale dhe lokale, administrata publike dhe gjyqësori) lidhur me shpërndarjen nacionale

**16.7.2.** Përqindja e popullatës të cilët besojnë se vendimmarrja është inkluzive dhe participative sipas gjinisë, moshës, personat me nevoja të veçanta dhe grupet e popullatës

## Pjesëmarrja politike e femrës në Strategjinë për barazi gjinore 2013 – 2020 dhe Plani aksionar 2013 – 2016 dhe kontributi drejt Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm

Strategjia për barazi gjinore përmes Qëllimit specifik strategjik 2.1 parasheh: Pjesëmarrje të rritur gjinore me përgjegjësi të femrave në proceset e vendimmarrjes në pushtetin ligjdhënës dhe ekzekutiv, në politikën partiake dhe veprimtarinë redaktuese radio-difuzëve përmes së cilës pritet të arrihen këto rezultate:

1. Pjesëmarrje e balancuar e femrave në trupat punuese të pushtetit ligjdhënës dhe ekzekutiv dhe integrimin e perspektivës gjinore në përmbushjen e kompetencave të Kuvendit
2. Masa të veçanta të miratuara për përfaqësim të drejt të femrave në pushtetin ekzekutiv
3. Kapacitete të forcuara të gjykatësve dhe prokurorëve publik për perspektivën gjinore në pushtetin e gjyqësorit



Qëllimet e SBGJ për avancimin e përfshirjes politike të femrës, në masë të madhe përputhet me detyrën 5.537 të QZHQ, të cilat kanë të bëjnë me sigurimin e pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të femrës dhe mundësi të barabarta për udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike. Më konkretisht, Strategjia jep vështrim mbi mungesën e përfshirjes së femrës në pushtetin ekzekutiv në nivel nacional dhe lokal, si dhe gjatë emërimit të ambasadorëve dhe përfaqësuesve diplomatik dhe prej këtu, parasheh masa për arritjen e rezultateve 1 dhe 2. Masat për përmbushjen e Rezultatit 1 kanë të bëjnë me avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të femrave në trupat punuese në nivel nacional dhe lokal, si dhe në trupat punuese dhe komisionet e parlamentit.

Për përmbushjen e Rezultatit 2 është paraparë vendosja e masave të veçanta për pjesëmarrje të balancuar të femrës në funksione udhëheqëse në administratën shtetërore dhe udhëheqjen dhe shpalljen e rregullt të statistikës së veçantë gjinore për funksionarët, nëpunësit shtetëror udhëheqës, ambasadorët e emëruar dhe përfaqësuesit diplomatik, si dhe anëtarët në këshillat drejtues të ndërmarrjeve publike dhe institucionet e emëruara nga Qeveria.

Rezultati 3 nuk është relevant për përmbushjen e qëllimeve për përfshirjen politike nga QZHQ dhe gjatë kësaj nuk do të merret parasysh në këtë analizë. Si përfundim, nëse implementohen aktivitetet për përmbushjen e Rezultateve 1 dhe 2, pritet se rezultatet në masë të madhe do të kontribuojnë drejt QZHQ dhe detyrës 5.538.

Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje dhe shkalla e pjesëmarrjes qytetare është një nga indikatorët kryesor për të qenit të hapur dhe demokratizimin e një shoqërie. Republika e Maqedonisë si pjesë e iniciativave të Partneritetit të hapur qeveritar angazhohet për institucione të hapura, transparente dhe të besueshme, të cilat komunikojnë dhe bashkëpunojnë me qytetarët. E rëndësishme është të theksohet se Strategjia për barazi gjinore aspak nuk është në korrelacion me nën qëllimin 16.7 dhe indikatorët 16.7.239 nga QZHQ dhe nga ana e shtetit nuk janë bërë hulumtime dhe analiza të cilat tregojnë për shkallën e pjesëmarrjes qytetare të femrës dhe meshkujve dhe mënyrën se si qytetarët mund të përfshihen në vendimmarrje në nivel lokal dhe nacional. Në SBGJ dhe PAN nuk ekzistojnë qëllime, aktivitete dhe indikatorë përmes të cilëve parashihet përfshirja e femrës në vendimmarrje jashtë proceseve politike.

Indikatorët në PAN lidhur me Qëllimin specifik strategjik 2.1 dhe rezultatet 1 dhe 2, të cilat janë të

37 Të sigurohet pjesëmarrja e tërësishme dhe efektive e femrës dhe mundësi të barabarta në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike

38 Të sigurohet pjesëmarrje e plotë dhe efektive e femrës dhe mundësi të barabarta për udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike

39 Përqindja e popullatës të cilët besojnë se vendimmarrja është inkluzive dhe participative sipas gjinisë, moshës, personat me nevoja të veçanta dhe grupi i popullatës

aplikueshme për AZHQ janë definuar, të matshme dhe relevante dhe përmes tyre mund të vëzhgohet avancimi i pjesëmarrjes politike të femrës. Shfaqja e të dhënave statistikore për përfshirjen politike të femrës dhe mashkullit është një nga indikatorët e AZHQ, por jo edhe të SBGJ dhe PAN dhe gjatë kësaj nevojitet angazhim më i madh nga ana e institucioneve për zbatimin e aktiviteteve që të mund të përcillet ky indikator. PAN parasheh Udhëheqje dhe shpallje të rregullt të statistikës së veçantë gjinore për funksionarët, nëpunësit shtetëror në pozita udhëheqëse, ambasadorët e emëruar dhe përfaqësuesit diplomat, si dhe anëtarët në këshillat drejtues të ndërmarrjeve publike dhe institucionet e emëruar nga Qeveria. Megjithatë, obligimi ligjor edhe më tej nuk respektohet dhe nuk ka të dhëna të veçanta gjinore për përbërjen gjinore të pozitave udhëheqëse të publikuara në ueb faqet e institucioneve, edhe pse kjo është pjesë e masave të parapara në Strategjinë dhe PAN.

Strategjia dhe PAN e njohin mungesën e të dhënave të veçanta gjinore – “mungon qasja e harmonizuar e grumbullimit të dhënave sipas gjinisë, e cila do të sigurojë bazë solide për analizimin e gjendjes dhe krijimin e politikave të cilat shpijnë drejt avancimit të barazisë gjinore. Gjatë kësaj, është vërtetuar nevoja për avancimin e treguesve statistikor dhe vendosjen e sistemit të harmonizuar të indikatorëve, që do t’u mundësojë të gjithë aktorëve qasje deri te të dhënat për shkak të analizës së gjendjes, paraqitjen e mungesave dhe dhënien e propozimeve adekuate dhe të dobishme për masat dhe aktivitetet e mëtejshme”.

Një nga indikatorët e këtij qëllimi është “kuota e rritur nga 40% të gjinisë më pak të përfaqësuar në listat e kandidatëve në Kodin zgjedhor”. Në vitin 2015, kuota e rritur në 40% për gjininë më pak të përfaqësuar, përmes së cilës do të nxitet pjesëmarrja e femrës në politikë, por mbetet të monitorohet implementimi i ligjit në zgjedhjet e ardhshme lokale dhe parlamentare.

## **Në cilën masë të dhënat nacionale dhe statistika për pjesëmarrjen politike të femrës janë të mjaftueshme për vëzhgim dhe raportin ndaj QZHQ**

Indikatorët në SBGJ, janë relevantë për arritjen e detyrës 5.540 nga QZHQ, por mungojnë të dhënat e veçanta gjinore të kapshme që është sfida më të cilën ballafaqohen institucionet duke e përfshirë Kuvendin, trupat punuese të Kuvendit, NJVL dhe partitë politike. Kuvendi dhe NJVL nuk mbajnë të dhëna të veçanta për numrin e femrave dhe meshkujve në Kuvend dhe në këshillat e vetëqeverisjes lokale, por përmes të dhënave publike në ueb faqen e Kuvendit dhe të NJVL-ve (në pjesën më të

40 Të sigurohet pjesëmarrje e plotë dhe efektive e femrës dhe mundësi të barabarta për udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike

madhe) mund të shihet numri i femrave në parlament dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Duke marrë parasysh se informatat ekzistojnë, nevojitet avancimi i kapaciteteve teknike për udhëheqje dhe azhurnimin e rregullt të statistikës së veçantë gjinore nga ana e shërbimit teknik të Kuvendit dhe NJVL.

Për shkak të mungesës së implementimit të obligimeve ligjore, tërësisht nuk mund të matet pjesëmarrja e femrës në pozita liderë dhe udhëheqëse të paraparë me indikatorin 5.5.241 Mungesa e këtyre të dhënave në mënyrë plotësuese ndikon mbi vendosjen e masave të veçanta, gjegjësisht e anulon vendosjen e masave të veçanta përmes të cilave edhe do të rritet numri i femrave në pozitat udhëheqëse në institucionet publike dhe shtetërore. Nga ana tjetër në Sektorin për mundësi të barabarta në 5 vitet e fundit është zbatuar vetëm një hulumtim për pjesëmarrjen e femrës në jetën publike dhe politike në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Megjithatë, në raportin e Avokatit të Popullit<sup>42</sup> ceket numri i përgjithshëm i personave të punësuar në administratën shtetërore dhe shpërndarja gjinore e personave të zgjedhur dhe të emëruar, personat në pozita udhëheqëse, pozita jo udhëheqëse dhe të punësuarit në organ. Duke u bazuar në të dhënat e raportit të Avokatit të Popullit, mund të shihet shpërndarja gjinore lidhur me pozitat e ndryshme, por edhe më tej mungon shpërndarja gjinore në pozitat udhëheqëse sipas institucioneve individuale, Për implementimin me sukses të SBGJ dhe përmbushjes së QZHQ, nevojitet edhe ngritja e kapaciteteve të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe Sektori për mundësi të barabarta për monitorim të suksesshëm, por edhe presion mbi institucionet të cilat nuk e implementojnë PAN, ndërsa me këtë edhe nuk i respektojnë obligimet ligjore dhe nuk i shpallin të dhënat e veçanta gjinore në ueb faqet resore.

Lidhur me indikatorët 16.7.143 për burim primar të dhënave<sup>44</sup> llogaritet udhëheqja e evidencës për punë administrative në nivel nacional në pajtim me obligimet e ICCPR dhe CEDAW. Grupet e ndryshme të popullatës do të definojnë në nivele të çdo vendi individualisht dhe në varësi prej grupeve etnike dhe fetare të cilat jetojnë në vend. Ky indikator sipas aspektit gjinor është relevant me çka do të tregohen dallimet gjinore lidhur me participimin e femrës dhe mashkullit në vendimmarrje. Të dhënat për këtë indikator duhet të ndahen në të gjitha nivelet e pushtetit lokal dhe nacional (Pushteti ekzekutiv, parlamenti, gjyqësori, policia etj.) në nivel të pozitive (menaxhment i lartë, nivel i mesëm i menaxhimit, profesional, personel ndihmës) dhe tipi i marrëveshjes (afatshkurtër, i përkohshëm dhe i përhershëm).

41 Përqindja e femrës në pozitat menaxheriale

42 Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë (2015) Raport vjetor për shkallën e sigurimit, respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, [http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2015/GI\\_2015-za\\_pecat.pdf](http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2015/GI_2015-za_pecat.pdf)

43 Përqindja e pozitive (sipas gjinisë, moshë, personat me nevoja të veçanta dhe grupi i popullatës) në institucionet publike (trupat ligdhënëse nacionale dhe lokale) lidhur me shpërndarjen nacionale

44 Fondi për popullatë pranë Kombeve të Bashkuara (2015) Kompilacioni i meta të dhënave për indikatorët për vëzhgimin global të Qëllimeve zhvillimore të qëndrueshme dhe tragjetet, <http://unstats.un.org/sdgs/files/Metadata%20Compilation%20for%20SDG%20Indicators%202023%20October%202015%20Update.pdf>

Indikator 16.7.145 gjegjësisht përqindja e pozitive (sipas gjinisë, moshës, personat me nevoja të veçanta dhe grupet e popullatës) në institucionet publike (trupat ligjdhënëse nacionale dhe lokale, administratën publike dhe gjyqësorin) lidhur me shpërndarjen nacionale grumbullohet nga ana e zyrës së Avokatit të Popullit. Edhe pse raporti i Avokatit të Popullit pjesërisht tregon ndarje gjinore të vendeve të punës në administratë, megjithatë nuk ekziston shpërndarje gjinore e të punësuarve në administratën shtetërore sipas përkatësisë etnike. Në mënyrë plotësuese, në raport mungojnë informacione për tipin e punësimit dhe marrëveshje gjegjësisht nëse të punësuarit janë me marrëveshje afatshkurtër, të përkohshme ose të përhershme. Analiza gjinore e të dhënave është mjaft e rëndësishme, duke marrë parasysh pjesëmarrjen e ulët të femrës në tregun e punës dhe diskriminimi me të cilin ballafaqohen femrat gjatë punësimit. Këto informata nuk grumbullohen nga ana e asnjë institucioni shtetëror ose nëse grumbullohen nuk kanë qasje publike.

Duke marrë parasysh indikatorin 16.7.246, participimi i pjesëmarrësve në vendimmarrje shpesh zbatohet përmes ENER, forumeve në bashkësi ose përmes bashkëpunimit (në projekte) me ndihmën e organizatave qytetare. Hulumtimet e zbatuara nga ana e organizatave qytetare janë të vetmet që mundësojnë të dhëna përmes të cilave mund të bëhet analizë për inkuadrimitin e qytetarëve në vendimmarrje dhe nëse vendimmarrja është inkluzive dhe participative. Po ashtu, nuk ka indikatorë të matës të cilët do ta matnin përqindjen e popullatës të cilët besojnë se vendimmarrja është inkluzive dhe participative sipas gjinisë, moshës, personat me nevoja të veçanta dhe grupe të popullatës.

---

45 Ibid

46 Përqindja e popullatës të cilët besojnë se vendimmarrja është inkluzive dhe participative sipas gjinisë, personat me nevoja të veçanta dhe grupet e popullatës

## Rekomandime

1. Për vëzhgimin e përparimit të shtetit në pikëpamje të barazisë gjinore indikatorët që vijnë për pjesëmarrjen politike të femrës/inkuadrimi i femrës të cilat janë rekomanduar nga QZHQ, nevojiten të analizohen në suaza të mekanizmave nacionale për raportim, si dhe të përfshihen gjatë përgatitjes së Raportit global për avancimin e gjendjes së mundësive të barabarta të femrës dhe mashkullit:

**Indikatori 5.5.1.** Përqindja e femrës në parlament dhe në këshillat e vetëqeverisjeve lokale.

**Indikatori 5.5.2.** Përqindja e femrës në pozita menaxheriale.

**Indikatori 16.7.1.** Përqindja e pozitave (sipas gjinisë, moshës, personat me nevoja të veçanta dhe grupet e popullatës) në institucionet publike (trupat ligjdhënëse nacionale dhe lokale, administrata publike dhe gjyqësori) lidhur me shpërndarjen nacionale.

**Indikatori 16.7.2.** Përqindja e popullatës të cilët besojnë se vendimmarrja është inkluzive dhe participative sipas gjinisë, moshës, personat me nevoja të veçanta dhe grupet e popullatës.

2. Në përgatitjen e PAN të ri të parashihen aktivitetet që vijnë me indikatorë matës për implementimin e të njëjtëve: Udhëheqja e të dhënave të veçanta statistikore për listat candidate dhe të vendeve të fituara në nivel nacional; Vendosija e praktikës për udhëheqje të Rregullores për punë të Kuvendit në pjesën e përfaqësimit të drejtë të dy gjinive në komisionet dhe trupat punuese; Raporti për përfaqësimin e drejtë të femrës dhe meshkujve në trupat dhe komisionet parlamentare; Të dhënat e veçanta gjinore për Kuvendin, trupat punuese dhe komisionet në ueb faqet e Kuvendit, Përfaqësimi i femrës në funksione udhëheqëse dhe të dhënat e publikuara në ueb faqet e ministrive resore.

3. MPPS/ESHS/Ministritë resorë/NJVL të grumbullojnë të dhëna të veçanta gjinore në të gjitha nivelet e pushtetit lokal dhe qendror (sipas përcaktimeve në SBGJ), në nivele të pozitës (menaxhmenti i lartë, niveli i mesëm i menaxhmentit, personeli ndihmës etj.) dhe tipi i marrëveshjes (afatshkurta, të përkohshme, të përhershme) që të identifikohen diskriminimi i bazuar në gjini (nëse ekziston).

Avokati i Popullit në raportet vjetore ta përfshijë edhe shpërndarjen gjinore të punësuarve sipas bashkësive etnike, kufizimit dhe të ndarë sipas institucioneve.

4. PAN i ri të parashohë hulumtime nacionale dhe analiza për përqindjen e popullatës të cilët besojnë se vendimarrja është inkluzive dhe participative sipas gjinisë, moshës, personat me nevoja të veçanta dhe grupet e popullatës.

## DHUNA E BAZUAR NË GJINI DHE QËLLIMET PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Në pajtim me Deklaratën e OKB-ve për eliminimin e dhunës mbi gruan<sup>47</sup>, dhuna mbi gruan paraqet “çdo akt i dhunës gjinore që rezulton ose ka gjasa të mëdha se do të rezultojë vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike ose lëndim të femrës duke përfshirë dhe ligjet me çdo lloj dhune, detyrimi ose lëndim i lirisë, si në jetën publike, ashtu edhe në atë private”. Definimi më gjithëpërfshirës është përmbajtja në Konventën e Këshillit të Evropës për pengimin dhe luftë kundër dhunës mbi femrën dhe dhunën familjare (Konventa e Stambollit<sup>48</sup>), sipas së cikës dhuna e bazuar në gjini mbi gratë kuptohet si shkelje të drejtave të njeriut dhe forma e diskriminimi mbi gratë dhe i shënon të gjitha aktet e dhunës së bazuar në gjini që sjellin ose me siguri do të sjellin deri te lëndimi ose vuajtja fizike, seksuale, psikike ose ekonomike e femrës, duke përfshirë edhe kërcënimet për aktet e tilla, privimi nga liria, pa marrë parasysh nëse ndodh në jetën publike ose private.

Vitet e kaluara në Republikën e Maqedonisë u zbatuan aktivitete të shumta lidhur me pengimin e dhunës familjare dhe tregtinë me femra dhe fëmijë. Mbetet sfida që të zbatohen masat dhe aktivitetet edhe kundër formave tjera të dhunës së bazuar në gjini, si shqetësimi seksual, përdhunimi, dhuna ekonomike, praktikat tradicionale dhe të dëmshme etj. Rekomandimet janë që dhuna e bazuar në gjini mbi femrat, si një nga format më të rënda të shkeljes së të drejtave të njeriut, duhet të shqyrtohen në mënyrë integrale dhe t’i përfshijnë të gjitha format e dhunës.

47 The Convention on the Elimination of all Forms of Discrimination Against Women – CEDAW (1987), United Nations General Assembly, <http://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/cedaw.pdf>

48 Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence (2011), Council of Europe, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168046031c>

Në kontekst të luftës kundër dhunës së bazuar në gjini në Republikën e Maqedonisë, disa qëllime dhe detyra nga QZHQ mund të ndahen si më relevante dhe janë lëndë e kësaj analize. Në të vërtetë, Qëllimi numër 5 nga AZHQ e njeh rëndësinë e parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna e bazuar në gjini mbi femrat përmes definimit të detyrave të veçanta, dhe atë: 5.2 për eliminimin e të gjitha formave të dhunës së bazuar në gjini mbi femrat dhe vajzat në sferën publike dhe private, duke përfshirë tregtinë me njerëz, formën seksuale dhe të tjera të eksploatimit: 5.3. eliminimi i të gjitha praktikave të dëmshme si martesat fëmijërore, të hershme dhe të detyruara dhe gjymtimi gjeneral femëror.

Po ashtu, QZHQ, përmes Qëllimit 11 dhe detyra 11.7 synon drejt sigurimit të qasjes universale deri te ambientet e sigurta, inkluzive dhe me qasje të gjelbra dhe publike, veçanërisht për femrat dhe fëmijët, pleqtë dhe personat me kufizime, me çka në mënyrë të drejtpërdrejtë do të kontribuojë drejt mbrojtjes së femrës nga DHBGJ në ambiente publike. Detyrat dhe indikatorët për dhunën e bazuar në gjini janë inkorporuar edhe në Qëllimin numër 16 për promovimin e shoqërore, të cilat janë paqësore dhe kanë qasje inkluzive drejt zhvillimit të qëndrueshëm, sigurimit të qasjes deri te drejtësia për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve vepruese, llogaridhënëse dhe inkluzive në të gjitha nivelet, gjegjësisht detyrat për zvogëlimin e të gjitha formave të dhunës dhe vdekja lidhur me dhunën kudo dhe fund keqpërdorimit, eksploatimit, tregtisë dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturës mbi fëmijët.

Në pajtim me Grupin mes agjencive dhe eksperte për indikatorët për QZHQ në suaza të komisionit për statistikë pranë Kombeve të Bashkuara, indikatorët përmes të cilëve vendet duhet ta vëzhgojnë progresin në parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës të bazuar në gjini mbi femrat janë:

## Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna e bazuar në gjini në Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm

### Detyrat

### Indikatorët

**5.2.** Eliminimi i të gjitha formave të dhunës së bazuar në gjini mbi gratë dhe vajzat në sferën publike dhe private, duke përfshirë tregtinë me njerëz, eksploatimi seksual dhe format tjera

**5.2.1.** Përqindja e grave dhe vajzave të moshës prej 15 vjet e më tepër, të cilat janë ekspozuar ndaj dhunës seksuale dhe psikologjike nga partneri intim i tanishëm ose i mëparshëm, në 12 muajt e kaluar, sipas formës së dhunës dhe grup moshës.

**5.2.2.** Përqindja e grave dhe vajzave të moshës deri në 15 vjet dhe më tepër, të cilat kanë qenë të ekspozuara nga dhuna seksuale nga personat tjerë, të cilët nuk kanë qenë partnerët e tyre intim, në 12 muajt e kaluar, sipas grup moshës dhe vendit të ngjarjes.

**5.3.** Eliminimi i të gjitha praktikave të dëmshme si martesat fëmijërore, të hershme dhe të detyruara dhe gjymtimi gjenital femëror.

**5.3.1.** Përqindja e femrave të moshës prej 20 – 24 vjet të cilat kanë qenë në martesë ose bashkësi para se t'i mbushin 15, gjegjësisht 18 vjet.

**11.7.** Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje universale deri te ambiente të sigurta, inkluzive dhe me qasje, të gjelbra dhe publike, veçanërisht për femrat dhe fëmijët, pleqtë dhe personat me nevoja të veçanta.

**11.7.2.** Përqindja e femrave të ekspozuara ndaj shqetësimit fizik ose seksual, sipas vendit të ngjarjes dhe profilit të dhunuesit (në 12 muajt e fundit).

**16.1.** Zvogëlimi i dukshëm i të gjitha formave të dhunës dhe vdekjes lidhur me dhunën kudo

**16.1.1.** Numri i vitiasve të vrasjes me paramendim, sipas gjinisë dhe moshës

**16.2.** Të vuhet fund keqpërdorimit, eksploatimit, tregtisë dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturës mbi fëmijët.

**16.2.3.** Përqindja e femrave dhe meshkujve të ri, të moshës prej 18 deri 29 vjet, të cilët kanë përjetuar dhunë deri në moshën 18 vjeçe.



## Dhuna e bazuar në gjini në Strategjinë për barazi gjinore 2013 – 2020 dhe Plani aksionar 2013 – 2016 dhe kontributi ndaj Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm

Strategjia nacionale për barazi gjinore 2013 – 2020 e veçon si qëllim të veçantë strategjik avancimin e kornizës ligjore, mbrojtjen dhe dënimin e dhunës së bazuar në gjini përmes Qëllimit specifik strategjik 2.2: Vetëdija e ngritur shoqërore për dhunën e bazuar në gjini dhe korniza e avancuar ligjore, e cila ofron standarde për mbrojtje dhe dënim efikas të formave të ndryshme të dhunës së bazuar në gjini.

Strategjia i definon rezultatet që vijojnë si kyçe për avancimin e parandalimit dhe mbrojtjes së dhunës së bazuar në gjini:

1. Njohja e dhunës së bazuar në gjini si dhunë e cila bazohet në mosbarazimin mes femrave dhe meshkujve në shoqëri
2. Kapacitete të forcuara të strukturave profesionale në të gjitha institucionet në fushën e mbrojtjes sociale, arsimimi, shëndetësia, mbrojtja dhe siguria, dhe ekonomia për njohjen e formave të ndryshme të DHBGJ.
3. Sistem i vendosur për grumbullimin sistematik të informatave për format e ndryshme të dhunës së bazuar në gjini
4. Përgjigje e avancuar institucionale dhe ,masa të vendosura specifike të mbrojtjes dhe sanksionimit të llojeve të ndryshme të DHBGJ

Nëse i krahasojmë rezultatet nga SBGJ me detyrat në QZHQ, mund të përfundojmë se pjesërisht janë të ndërlidhura dhe kontribuojnë drejt detyrave të lartpërmendura. Strategjia përmend se dhuna e bazuar në gjini bazohet në pabarazinë mes meshkujve dhe femrave në shoqëri dhe flet për njohjen e formave të ndryshme të dhunës së bazuar në gjini. Më tej, rezultatet e parapara në Strategji tregojnë për nevojën për grumbullim sistematik të informatave për format e ndryshme të DHBGJ dhe të njëjtat janë shndërruar në propozim aktivitete në Planin aksionar 2013 – 2016, përmes aktivitetit për zbatimin e hulumtimit nacional për paraqitjen dhe shpeshinë e dhunës së bazuar në gjini.

Moment i rëndësishëm është se SBGJ është dokumenti i parë i cili jep definicion për dhunën e

bazuar në gjini. Në të vërtetë, rregullativa ligjore dhe dokumentet strategjike në Republikën e Maqedonisë pothuaj tërësisht kanë të bëjnë me dhunën familjare. Ligji për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna familjare, vetëm në fjalorin e termeve sqaron se “dhuna e bazuar në gjini mbi femrat nënkupton dhunë të orientuar kundër femrës sepse ajo është grua ose në mënyrë disproporcionale e godet”.<sup>49</sup> Prej këtu edhe sfida kryesore në përmbushjen e detyrave dhe vëzhgimi i indikatorëve të QZHQ: zbatimi i masave dhe aktiviteteve dhe kundër formave tjera të dhunës së bazuar në gjini si shqetësimi seksual, përdhunimi, dhuna ekonomike, praktikat tradicionale dhe të dëmshme etj. Në të vërtetë, së pari është e domosdoshme të bëhet definimi i saktë i të gjitha formave të dhunës së bazuar në gjini në të gjitha dokumentet strategjike dhe ligjet, që të mund të punohet në drejtim të realizimit të detyrave dhe vëzhgimi i indikatorëve nga AZHQ.

Plani ekzistues aksionar nacional për barazi gjinore 2013 – 2016, si pjesë e qëllimit specifik strategjik, parasheh aktivitete për mbrojtjen dhe sanksionimin e dhunës së bazuar në gjini përmes fushatave për ngritjen e vetëdijes dhe ndërtimin e kulturës së mos tolerancës së dhunës të bazuar në gjini; aktivitete informative në institucionet arsimore në të gjitha nivelet në sistemin arsimor; trajnim i kuadrove profesionale dhe ligjërata në universitete; zbatimi i hulumtimeve nacionale për paraqitjen dhe shpeshinë e dhunës së bazuar në gjini dhe përpilimi dhe vendosja e metodologjisë së vetme dhe sistemi për grumbullimin e koordinuar të informatave; analiza e sistemit juridik dhe masave për mbrojtje dhe rekomandime për ndryshime adekuate, të cilat do të sigurojnë mbrojtje dhe dënim efikas dhe në kohë dhe përgatitja e Programit nacional të mbrojtjes dhe re integritit të femrës të cilat janë viktima të DHBGJ.

Njëlloj edhe në SBGJ dhe në PAN nuk janë definuar indikatorët matës dhe relevant përmes të cilëve mund të vëzhgohet progresi dhe ndikimi i politikave dhe programeve për pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna mbi gratë në pikëpamje të barazisë gjinore. Në strategjinë nacionale janë përmendur vetëm rezultatet, derisa planet aksionare definojnë indikatorë në nivel procesi të cilët e matin suksesin dhe përqindjen e realizimit të aktiviteteve dhe në pjesën më të madhe kanë të bëjnë me ngritjen e vetëdijes dhe forcimin e kapaciteteve. Vetëm indikator i viktimit të identifikuar të dhunës së bazuar në gjini dhe numri i shërbimeve të siguruar për mbështetje dhe re integritimi, japin mundësi për vëzhgimin dhe matjen e cilësisë dhe ndikimit të aktiviteteve

<sup>49</sup> Neni 4, alineja 10 nga Ligji për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna familjare, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 138/2014, 33/2015 и 150/2015)

të ndërmarra, edhe pse informatat duhet të veçohen edhe sipas formës së dhunës, grup moshës, vendit të ngjarjes dhe përkatësisë etnike.

Gjithsesi, duhet të merret parasysh edhe fakti se vetë strategjia flet për nevojën nga vendosja e sistemit dhe metodologjisë për grumbullim të koordinuar të informatave për forma të ndryshme të DHBGJ. Po ashtu, në qëllimin strategjik 2.2 nga PAN përmenden aktivitetet për zbatimin e hulumtimit nacional për paraqitjen dhe shpeshtinë e dhunës së bazuar në gjini dhe përpunimi dhe vendosja e metodologjisë së vetme dhe sistem për grumbullimin e koordinuar të informatave. Për fat të keq aktivitetet e parapara nuk janë realizuar nga ana e institucioneve përgjegjëse, kështu qasja deri te informatat relevante akoma paraqesin mungesë kyçe dhe sfidë në këtë fushë.

### **Në cilën masë informatat nacionale dhe statistika për pjesëmarrjen politike të femrës janë të mjaftueshme për vëzhgimin dhe raportimin ndaj QZHQ**

Informata të shpallura publike të kapshme dhe pro aktive nga grumbullimi sistematik i informatave të ndara statistikore, por edhe të dhëna nga hulumtimet për popullatën e përgjithshme, janë mungesa kryesore kur flasim për vëzhgimin e dhunës së bazuar në gjini mbi femrat në Republikën e Maqedonisë, që njëherë paraqet edhe sfidë për vëzhgimin e realizimit të QZHQ në pjesën e DHBGJ. MPPS mban evidencë të rasteve të paraqitura të dhunës familjare, sipas gjinisë, tipit të dhunës dhe masave të shqiptuara për mbrojtjen e përkohshme. MPB punon mbi evidentimin e rasteve të evidentuara të dhunës familjare sipas vendit të ngjarjes, gjinisë së viktimës dhe dhunuesit dhe kualifikimit juridik. Lidhur me tregtinë me njerëz, në MPPS është vendosur sistem i grumbullimi të dhënave statistikore të tregtisë me njerëz, për vëzhgimin e trendit të kësaj dukurie pa u grumbulluar dhe përpunuar të dhënat personale, me qëllim të mbrojtjes së identitetit dhe të dhënave tjera personale të viktimës.

ESHS në raportet vjetore për mbrojtje sociale të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve50, jep pasqyrë të rasteve të evidentuara të keqpërdorimit seksual, si dhe evidencë të numrit të miturve, të cilët kanë dashur të lidhin martesë para se t'i mbushin 18 vjet. Gjatë kësaj, të dhënat e publikuara prezantohen në nivel vjetor, sipas gjinisë dhe moshës. Po ashtu, edhe pse me PAN është paraparë hulumtimi nacional për paraqitjen dhe shpeshtinë e formave të ndryshme të dhunës së bazuar

50 Enti shtetëror për statistikë (2015). Mbrojtja sociale e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve, 2014 – 2015. Gjetet në <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.15.17.pdf>

në gjini mbi femrat, siç është dhuna seksuale dhe psikologjike, ky aktivitet nuk është realizuar për shkak se praktikisht është e pamundur të vëzhgohen indikatorët 5.2.151 dhe 5.2.252 nga QZHQ.

Indikator 5.3.153 po ashtu mund të vëzhgohet pasi që në raportet e deritanishme për mbrojtje sociale të fëmijëve, të miturve dhe të rriturve, të cilët i publikon Enti shtetëror për statistikë. Ekziston vetëm numër i rasteve të evidentuara të personave të cilët kanë shprehur interesim për lidhjen e martesës para se t'i mbushin 18 vjet. Kjo do të thotë se nuk ka kurrfarë evidence të rasteve të vajzave dhe djemve të mitur në bashkësi, gjegjësisht nuk janë regjistruar, edhe pse në pajtim me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna mbi femrat dhe dhuna familjare, martesat minore janë një nga format e dhunës së bazuar në gjini, që për fat të keq shumë rrallë njihen dhe adresohen si të tilla. Me qëllim të rritjes së dukshmërisë së këtij problemi së pari nevojitet të hulumtohet për përfshirjen e këtij problemi, që të vlerësohet numri i fëmijëve të cilët janë nën ndikim të martesave të hershme dhe të detyruara, duke përfshirë edhe martesat tradicionale të cilat nuk janë regjistruar te organet kompetente dhe të zhvillohen masa korigjuese për zvogëlimin dhe çrrënjosjen e kësaj praktike.

Indikator 11.7.254 i cili ka të bëjë me përqindjen e femrave të ekspozuara ndaj shqetësimit fizik ose seksual sipas vendit të ngjarjes dhe profilit të dhunuesit, po ashtu nuk mund të ndiqet pasi që nuk ekziston definim i saktë, njohja dhe sistemi për paraqitje dhe vëzhgimi i këtyre llojeve të dhunës së bazuar në gjini në shtetin tonë, si forma të dhunës mbi gratë. Po ashtu ka të bëjë edhe me indikatorin 16.2.355.

Siç mund të vërehet, në Republikën e Maqedonisë të dhënat e kapshme kanë të bëjnë vetëm me disa forma të dhunës së bazuar në gjini mbi gratë, gjatë kësaj të dhënat nuk klasifikohen sipas të gjitha kategorive relevante si përkatësia etnike, lokacioni gjeografik etj., në pajtim me parimin “askush mos lihet anësh”. Shkurtimisht, mund të përfundojmë se të dhënat ekzistuese në Republikën e Maqedonisë nuk janë të mjaftueshme që të vëzhgohen indikatorët nga QZHQ relevante për

- 
- 51 Përqindja e grave dhe vajzave të moshës prej 15 vjet e më tepër, të cilat kanë qenë të ekspozuara ndaj dhunës seksuale ose psikologjike nga partneri intim i tanishëm ose i mëparshëm, në 12 muajt e kaluar, sipas formës së dhunës dhe grup moshës.
- 52 Përqindja e grave dhe vajzave të moshës prej 15 vjet e më tepër, të cilat kanë qenë të ekspozuara ndaj dhunës seksuale ose psikologjike nga partneri intim i tanishëm ose i mëparshëm, në 12 muajt e kaluar, sipas grup moshës dhe vendit të ngjarjes
- 53 Përqindja e femrave të moshës prej 20 deri 24 vjet të cilat kanë qenë në martesë ose bashkësi para se t'i bushin 15 vjet, gjegjësisht 18 vjet.
- 54 Përqindja e femrës të ekspozuar ndaj shqetësimit fizik ose seksual, sipas vendit të ngjarjes dhe profilit të dhunuesit (në 12 muajt e kaluar).
- 55 Përqindja e vajzave dhe meshkujve të ri të moshës prej 18 deri 29 vjet të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale deri në moshën 18 vjeçare.

DHBGJ, ndërsa përjashtim paraqet indikator 16.1.156 i cili në tërësi mund të vëzhgohet pasi që MPB disponon me këto të dhëna.

---

56 Numri i viktimave të vrasjes me paramendim, sipas gjinisë dhe moshës.

## Rekomandime

1. Gjatë përgatitjes së planeve aksionare për barazi gjinore të përfshihen aktivitetet dhe indikatorët për ballafaqim me të gjitha format e dhunës së bazuar në gjini mbi femrat, të cilët janë relevantë dhe në pajtim me qëllimet dhe indikatorët e rekomanduar nga QZHQ, por dhe të përfshihen gjatë përgatitjes së Raportit vjetor për avancimin e gjendjes së mundësive të barabarta të femrave dhe meshkujve

**Indikatori 5.2.1.** Përqindja e grave dhe vajzave të moshës prej 15 vjet e më tepër, të cilat kanë qenë të ekspozuara ndaj dhunës seksuale ose fizike nga partneri intim i tanishëm ose i mëparshëm, në 12 muajt e kaluar, sipas formës së dhunës dhe grup moshës.

**Indikatori 5.2.2.** Përqindja e grave dhe vajzave të moshës prej 15 vjet dhe më tepër, të cilat kanë qenë të ekspozuara ndaj dhunës seksuale nga persona tjerë të cilët kanë qenë partnerë të tyre intim në 12 muajt e kaluar, sipas grup moshës dhe vendit të ngjarjes.

**Indikatori 5.3.1.** Përqindja e femrës të moshës prej 20 deri 24 vjet të cilat kanë qenë në martesë ose bashkësi para se t'i mbushin 15, gjegjësisht 18 vjet.

**Indikatori 11.7.2.** Përqindja e femrave të ekspozuara ndaj shqetësimit fizik ose seksual, sipas vendit të ngjarjes dhe profilit të dhunuesit (në 12 muajt e fundit).

**Indikatori 16.1.1.** Numri i viktimave të vrajës me paramendim, sipas gjinisë dhe moshës.

**Indikatori 16.2.3.** Përqindja e femrave dhe meshkujve të ri, të moshës prej 18 deri 29 vjet të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale deri në moshën 18 vjeçare.

2. Harmonizimi i definicioneve për dhunën mbi femrat, dhunën e bazuar në gjini mbi femrat dhe të gjitha format e dhunës mbi femrat në ligjet/nën ligjet, aktet/strategjitë dhe politikat relevante, në pëlqim me deklaratat dhe konventat e miratuara;

3. Raportet publike vjetore të kapshme për aktivitetet nga mandatet e trupave zyrtare shtetërore koordinuese për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna e bazuar në gjini mbi gratë;
4. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve dhe të sistemeve për grumbullimin e të dhënave statistikore, administrative dhe gjyqësore për të gjitha format e dhunës së bazuar në gjini mbi femrat, të ndara sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, relacionit viktimë-kryes, lokacioni gjeografik, kufizimet, si dhe përmirësimi i qasjes deri te të dhënat për opinionin;
5. Zbatimi i hulumtimeve nacionale relevante të formave të ndryshme të dhunës së bazuar në gjini, në të cilat janë përfshirë edhe të dhënat e veçanta sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, kufizimit, të ardhurave, vendit të banimit;
6. PAN i ri të parashohë vendosjen e shërbimeve të specializuara për ,mbështetje të femrave të cilat kanë përjetuar dhunë të bazuar në gjini (në pajtim me numrin e popullatës dhe distribuimi gjeografik) dhe ta vëzhgoje vlerën e mjeteve të ndara buxhetore nga shteti në nivel shtetëror për funksionimin e këtyre shërbimeve, që t'u përgjigjet përmbushjes së QZHQ, të cilat i njohin të gjitha format e ndryshme të DHBGJ.



ПЛАТФОРМА  
ЗА РОДОВА  
ЕДНАКВОСТ



X. E. P. A.

асоциација за здравствена едукација и истражување



A Member Association of



**IPPF**

European Network

International  
Planned Parenthood  
Federation